REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**

**DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL**

**PROJEKT VENDIM**

**Nr.13730/13 datë 06/08/2025**

**"PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR SOCIAL 2026-2028"**

Në mbështetje të nenit 113 pika 1 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 8 pika 2, neni 29 pika 1, Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore",
Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030;
Ligji 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024; Strategjia për PAK, barazinë gjinore, të moshuarit dhe grupet vulnerabël, Kuadri i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të) në nivel vendor.
Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026; Ligji Nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës";Ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale"; Ligjin nr. 163/2014 "Për urdhrin e punonjësit social";Aktet nënligjore që rregullojnë shërbime specifike si: VKM për standardet e shërbimeve për fëmijë, për PAK, për të moshuar, viktima të dhunës, etj.;
Konventa ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, si Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Kryetari i Bashkisë i paraqet Këshillit të Bashkisë Lezhë;

**P R O P O Z O J:**

1. Miratimin e Planit Vendor të Veprimit Social 2026-2028.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**
**Pjerin NDREU**

**NË MUNGESË DHE ME URDHER**
**ZV.KRYETAR**
**Brikena VUKSANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LEZHË**

**DREJTORIA E SHËRBIMIT DHE KUJDESIT SOCIAL**

Nr.13730/1 Prot                                                                 Lezhë, më 06.08.2025

**Relacion për Projekt Vendimin mbi miratimin e Planit Vendor Social 2026-2028**

Projekt vendimi është hartuar në mbështetje të Ligjit 139, Neni 54 pika K" Këshilli Bashkiak miraton norma, standarde e kritere për rregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe për mbrojtjen e garantimin e interesit publik;.
Në mbëshetje të nenit 113 pika 1 e Kushtetutes së Republikes se Shipërise, neni 8 pika 2, neni 29 pika 1, Ligjit Nr. 139/2015 "Per vetëqeverisjen Vendore", Ligjit Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror ne Republiken e Shipërise" ndryshuar.
Objekti i këtij Projekt-Vendimi është miratimi i Planit Vendor Social 2026-2028 të Bashkisë Lezhë, si një dokument strategjik vendor ku synon të analizojë gjëndjen ekzistuese të shërbimeve sociale në territor, të identifikojë boshllëqet dhe sfidat, si dhe të përkufizojë objektiva të qarta për periudhën trevjeçare 2026-2028. Dokumenti është hartuar në përputhje me legjislacionin kombëtar, strategjitë përkatëse sektoriale dhe standardet minimale të shërbimeve, duke integruar gjithashtu kontributet e komunitetit dhe aktorëve të shumtë lokalë.
Përmes këtij Plani, Bashkia Lezhë synon të fuqizojë sistemin komunitar të mbrojtjes dhe kujdesit social, të përmirësojë aksesin, cilësinë dhe gjithëpërfshirjen e shërbimeve, si dhe të rrisë kapacitetet institucionale për të përmbushur me përgjegjësi misionin e saj ndaj qytetarëve më në nevojë. Hartimi i këtij plani është zhvilluar në periudhën Shkurt-Korrik 2025, përmes një procesi konsultativ dhe të bazuar në evidencë, nën koordinimin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale. Procesi i hartimit të Planit Social për Bashkinë Lezhë është zhvilluar përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, e mbështetur në të dhëna, konsultim me aktorët lokalë dhe orientim drejt standardeve kombëtare.
Kërkohet miratimi nga Keshilli Bashkiak i Lezhes i Planit Vendor Social 2026-2028 .
Miratimi i ketij dokumenti do t'i japë bashkisë Lezhë një bazë të fortë për veprime konkrete, një hartë rruge ligjërisht të vlefshme e cila ndihmon të koordinojë aktorët dhe të përmirsojë jetën e qytetarëve.
Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

**K R Y E T A R I**
**Pjerin NDREU**

**NË MUNGESË DHE ME URDHER**
**ZV.KRYETAR**
**Brikena VUKSANI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA LEZHË

BASHKIA LEZHË

# Plani Vendor Social

Bashkia Lezhë

2026-2028



BASHKIA **LEZHË**

# Falenderime

Bashkia Lezhë shpreh mirënjohjen e saj të veçantë për të gjithë ata që kontribuan në hartimin e Planit Vendor Social 2026-2028. Ky proces është realizuar me mbështetjen e Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë (SHKBSH) dhe me ekspertizën teknike të "Smart Processes", të cilët lehtësuan analizën, planifikimin dhe ndërtimin metodologjik të këtij dokumenti strategjik.

Falënderojmë në mënyrë të veçantë Këshillin Bashkiak të Bashkisë Lezhë, i cili ka mbështetur këtë proces duke siguruar një qasje të hapur dhe gjithëpërfshirëse në hartimin e planit.

Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e drejtuesve të bashkisë, përfaqësuesve të drejtorive e sektorëve vendorë, organizatave të shoqërisë civile, grupeve komunitare dhe partnerëve lokalë që morën pjesë aktivisht në takime konsultative dhe ndihmuan në pasqyrimin e nevojave të vërteta të komunitetit.

BASHKIA **LEZHË**

# Tabela e përmbajtjes


Falenderime ... 2
1. Hyrje ... 5
2. Metodologjia ... 5
3. Legjislacioni dhe Baza Ligjore ... 7
3.1 Kuadri kushtetues dhe ligjor ... 8
3.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar ... 9
3.3 Roli i Bashkisë dhe Strukturave të tyre në ngritjen e Shërbimeve Sociale ... 10
3.3.1 Kompetencat ligjore të bashkive ... 10
3.3.2 Struktura përgjegjëse brenda bashkisë ... 10
3.3.3 Parimet themelore në ofrimin e shërbimeve sociale ... 11
3.4 Kategoritë e shërbimeve sociale ... 13
3.5 Modalitetet e ofrimit të shërbimeve ... 17
3.6 Kërkesa ligjore për profesionistët socialë ... 17
3.7 Qendrat Sociale që ofrojnë Shërbime në Qytetin e Lezhës ... 18
3.8 Prioritetet në zgjerimin e hartës së shërbimeve ... 19
4. Analiza e të dhënave- vështrim i përgjithshëm ... 20
4.1 Numri i popullsisë sipas gjinisë ... 21
5. Individë në Nevojë për Shërbime dhe Shërbimet Egzistuese ... 21
5.1 Individë që përfitojnë Ndihmë Ekonomike sipas njësive administrative ... 21
5.1.1 Familjet përfituese të ndihmës ekonomike ... 21
5.1.2 Struktura sipas gjinisë ... 23
5.1.3 Struktura sipas grupmoshave ... 24
5.1.4 Karakteristikat e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike ... 24
5.1.5 Punëkërkuesit e papunë në Bashkinë Lezhë ... 25
5.1.6 Punëkërkuesit e papunë sipas kategorive ... 26
5.2 Personat me Aftësi të Kufizuara - Analizë e Shpërndarjes dhe Nevojave ... 28
5.2.1 Madhësia e Grupit dhe Shtrirja në Territor ... 28
5.2.2 Karakteristikat e Aftesise së Kufizuar ... 30
5.2.2.1 Personat me Aftësi të Kufizuara në Shikim ... 30
5.2.2.2 Personat me Aftësi të Kufizuara Para-Tetraplegjik ... 31
5.2.2.3 Personat me Aftësi të Kufizuara Fizike dhe Mendore ... 32
5.2.3 Përfshirja në Arsim e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara ... 34
5.2.4 Punësimi i Personave me Aftësi të Kufizuara ... 34
5.2.5 Shërbimi i strehimit social ... 34
5.2.6 Shërbimi Shëndetësor ... 34
5.2.7 Shërbimet zhvilluese dhe rehabilituese sociale ... 35
6. Viktima të dhunës në familje ... 36
6.1 Shërbimet e ofruara për viktimat e dhunës në familje në Bashkinë Lezhë ... 37
6.2 Mekanizmi i Referimit për rastet e dhunës në familje në Bashkinë Lezhë ... 38

7.Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale ... 39
7.1 Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale sipas njësive administrative ... 39
7.2 Shërbimet e kujdesit shoqëror për të moshuarit ... 40
8. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje ... 43
8.1 Madhësia e grupit dhe shtrirja në territor ... 43
8.2 Fëmijë në Nevojë për Mbrojtje, me Aftësi të Kufizuara ... 45
8.3 Shërbimet për fëmijët në Bashkinë Lezhë ... 46
8.4 Shërbimi i Kujdesit për Fëmijët e Moshës 0–3 vjeç (Çerdhja) ... 47
9.Familjet rome dhe egjiptiane ... 48
9.1 Madhësia e grupit dhe shtrirja në territor ... 48
9.2 Shërbimet për familjet rome dhe egjiptiane ... 48
10.Personat me varësi nga droga dhe nga alkooli ... 50
10.1 Madhësia, karakteristikat e grupit dhe shtrirja në territor ... 50
11. Shërbimet Bazë që ofron Bashkia Lezhë ... 51
12. Vizioni dhe Misioni ... 54
12.1 Vizioni ... 54
12.2 Misioni ... 54
13. Plani i Veprimit 2026-2028 ... 55
14. Matrica e Veprimit të Planit Social 2026-2028 ... 56
15. Monitorimi dhe raportimi ... 75
16. Bibliografi ... 77

# 1. Hyrje

Plani Social i Bashkisë Lezhë për periudhën 2026-2028 është një dokument strategjik që udhëheq vendimmarrjen në fushën e shërbimeve sociale në nivel vendor, në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe zhvillimit gjithëpërfshirës. Hartimi i këtij plani është zhvilluar në periudhën Shkurt-Korrik 2025, përmes një procesi konsultativ dhe të bazuar në evidencë, nën koordinimin e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale.

Ky proces u mbështet nga ekspertë të fushës dhe u orientua nga praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare për planifikimin social. Bashkia Lezhë ka ndërtuar një përvojë të vyer ndër vite në adresimin e nevojave të grupeve vulnerabël, duke konsoliduar shërbime dhe partneritete në nivel vendor dhe rajonal.

Plani synon të analizojë gjendjen ekzistuese të shërbimeve sociale në territor, të identifikojë boshllëqet dhe sfidat, si dhe të përkufizojë objektiva të qarta për periudhën trevjeçare 2026-2028. Dokumenti është hartuar në përputhje me legjislacionin kombëtar, strategjitë përkatëse sektoriale dhe standardet minimale të shërbimeve, duke integruar gjithashtu kontributet e komunitetit dhe aktorëve të shumtë lokalë.

Përmes këtij Plani, Bashkia Lezhë synon të fuqizojë sistemin komunitar të mbrojtjes dhe kujdesit social, të përmirësojë aksesin, cilësinë dhe gjithëpërfshirjen e shërbimeve, si dhe të rrisë kapacitetet institucionale për të përmbushur me përgjegjësi misionin e saj ndaj qytetarëve më në nevojë.

# 2. Metodologjia

Procesi i hartimit të Planit Social për Bashkinë Lezhë është zhvilluar përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, e mbështetur në të dhëna, konsultim me aktorët lokalë dhe orientim drejt standardeve kombëtare. Më poshtë paraqiten hapat e ndjekur:

**1. Analiza e kuadrit ligjor dhe strategjik kombëtar**

Fillimisht u realizua një shqyrtim i detajuar i dokumenteve ligjore dhe strategjike që udhëheqin planifikimin e politikave sociale në nivel kombëtar. Në fokus ishin:

- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030;
- Ligji 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024;

- Strategjia për PAK, barazinë gjinore, të moshuarit dhe grupet vulnerabël,
- Kuadri i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-të) në nivel vendor.

Kjo analizë shërbeu për të përcaktuar detyrimet dhe prioritetet që bashkia duhet të adresojë në nivel lokal.

**2. Konsultimi me aktorë lokalë dhe ofrues shërbimesh**

U zhvilluan takime konsultative me një gamë të gjerë aktorësh, për të siguruar që prioritetet e planit të reflektojnë realisht nevojat dhe perspektivat në terren. Këtu përfshihen:

- Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe stafi teknik i bashkisë,
- Administratorë vendorë dhe përfaqësues të njësive administrative,
- Përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizatave që ofrojnë shërbime sociale,
- Partnerë të tjerë ndërinstitucionalë (arsimi, shëndetësia, policia, etj).

**3. Analiza e të dhënave sociale dhe administrative**

U mblodhën dhe u analizuan të dhëna të detajuara nga burime të ndryshme, përfshirë:

- Sistemi elektronik i shërbimeve sociale,
- Të dhëna administrative nga bashkia dhe njësitë administrative,
- Regjistrat e ndihmës ekonomike, PAK, pensioneve dhe shërbimeve ekzistuese,
- Statistikat e INSTAT dhe institucioneve kombëtare të monitorimit social.

Kjo analizë ndihmoi në identifikimin e grupeve në nevojë, shportës së shërbimeve ekzistuese, dhe zonave me mungesa të theksuara në mbulim.

**4. Vlerësimi i boshllëqeve në raport me standardet kombëtare**

Bazuar në standardet e shërbimeve të kujdesit shoqëror të miratuara nga Ministria përkatëse, u krye një vlerësim i kapaciteteve dhe mbulimit aktual në Bashkinë Mat. Ky vlerësim ndihmoi në:

- Identifikimin e boshllëqeve në infrastrukturë dhe burime njerëzore,
- Përcaktimin e shërbimeve të reja të nevojshme,
- Prioritizimin e ndërhyrjeve për periudhën 2026-2028.

**5. Hartimi i objektivave dhe Planit të Veprimit**

Bazuar në të dhënat, konsultimet dhe boshllëqet e evidentuara, u formulua struktura logjike e Planit Social, përfshirë:

- Objektivat strategjikë dhe specifikë,
- Masat konkrete të ndërhyrjes,
- Treguesit e monitorimit,
- Aktorët përgjegjës dhe afatet për zbatim.

## 3. Legjislacioni dhe Baza Ligjore

Shqipëria ka zhvilluar kuadrin ligjor mbi mbrojtjen dhe përfshirjen sociale duke rregulluar kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, fëmijëve, moshuarve, viktimave të dhunës ne familje etj. Një rol të vecantë në ngritjen dhe fuqizimin e shërbimeve sociale kanë edhe bashkitë.

Kjo rubrikë synon të paraqesë një përmbledhje të qartë, të strukturuar dhe të zbatueshme të shërbimeve sociale që ofrohen në nivel vendor në Republikën e Shqipërisë. Ai shërben si një udhëzues praktik për bashkitë dhe institucionet e tjera të përfshira në projektimin, ofrimin dhe monitorimin e këtyre shërbimeve, në mënyrë që ato të jenë në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të përmbushin nevojat e individëve dhe grupeve në nevojë.

Standardet minimale përcaktojnë nivelin themelor të cilësisë, disponueshmërisë dhe aksesueshmërisë që një shërbim social duhet të përmbushë. Ato janë element thelbësor për sigurimin e një ofrimi të barabartë dhe të pandryshueshëm të shërbimeve në të gjitha bashkitë, mbështetjen e punës profesionale të strukturave vendore dhe ofruesve të tjerë të licencuar si dhe promovimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe përmirësimit të vazhdueshëm në ofrimin e ndihmës sociale.

Dokumenti mbështetet në:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030;
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026;
- Ligji 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024;
- Ligji Nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës";
- Ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale";

- Ligjin nr. 163/2014 "Për urdhrin e punonjësit social";
- Aktet nënligjore që rregullojnë shërbime specifike si: VKM për standardet e shërbimeve për fëmijë, për PAK, për të moshuar, viktima të dhunës, etj.;
- Konventa ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria, si Konventa për të Drejtat e Fëmijës dhe Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

### 3.1 Kuadri kushtetues dhe ligjor

Garantimi i shërbimeve sociale në Shqipëri mbështetet në parimet themelore të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në **Kreun V-Objektivat Sociale**, përmes **Neni 59**, shteti angazhohet të përmbushë detyrimet e tij ndaj qytetarëve në nevojë, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon. Këto objektiva përfshijnë promovimin e punësimit, sigurimin e të drejtës për strehim, aksesin në shërbime shëndetësore dhe arsim, përkujdesjen për të moshuarit, jetimët, invalidët dhe personat me aftësi të kufizuara, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës për shtresat më të cenueshme të shoqërisë. Ky kuadër normativ përbën themelin mbi të cilin ndërtohen politikat dhe programet për mbrojtjen sociale dhe përfshirjen e barabartë të qytetarëve në jetën shoqërore dhe ekonomike.

**Ligjet kryesore përfshijnë:**

| | |
|---|---|
| **Ligji 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024;** | Ky ligj vendos bazat e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, duke theksuar rolin qendror të bashkive në planifikimin, sigurimin dhe financimin e këtyre shërbimeve, si dhe në monitorimin e cilësisë dhe zbatimin e standardeve minimale. |
| **Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"** | Sanksionon se bashkitë kanë kompetencë ekskluzive për të ofruar dhe organizuar shërbime sociale për banorët e tyre. Neni 24 "Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale ", Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve:<br>1. Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktima të |

| | |
|---|---|
| | trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.<br>2. Ndërtimin dhe administrimin e banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.<br>3. Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore.<br>4. Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. |
| **Ligji nr. 57/2019 "Për asistencën sociale"** | Regullon ndihmën ekonomike dhe përfshirjen e bashkive në procesin e identifikimit, vlerësimit dhe miratimit të përfituesve të skemës së ndihmës. |
| **Ligji nr. 163/2014 "Për urdhrin e punonjësit social"** | Vendos rregulla për profesionin e punonjësit social, përfshirë kriteret e edukimit, etikës dhe licencimit. Ky ligj lidhet drejtpërdrejt me standardet për personelin që ofron shërbime sociale. |

### 3.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar

Shqipëria është palë nënshkruese dhe ratifikuese e disa konventave ndërkombëtare që ndikojnë drejtpërdrejt në politikëbërjen dhe standardizimin e shërbimeve sociale. Gjithashtu Shqipëria është në process të përafrimit të legjislacionit me BE në kuadër të procesit të antarësimit. Këto instrumente ndërkombëtare janë reflektuar në legjislacionin kombëtar dhe përbëjnë bazën për monitorim ndërkombëtar dhe përgjegjshmëri në zbatimin e të drejtave sociale.

Në konventat kryesore të ratifikuara nga shteti shqiptar mund të listojmë:

- ✓ **Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC)**

Kërkon ofrimin e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror dhe vendos standarde për trajtimin e fëmijëve në institucionet sociale.

- ✓ **Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (CRPD)**

Neni 19 thekson të drejtën për jetesë të pavarur dhe përfshirje në komunitet me mbështetjen e duhur.

- ✓ Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) ratifikuar me Ligjin nr. 104/2012;
- ✓ Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave CEDAË;
- ✓ Deklarata e vitit 1993 për Eliminimin e dhunës ndaj grave;
- ✓ Deklarata e Pekinit e vitit 1995 dhe Platforma në Veprim.

## 3.3 Roli i Bashkisë dhe Strukturave të tyre në ngritjen e Shërbimeve Sociale

### 3.3.1 Kompetencat ligjore të bashkive

Bazuar në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", bashkitë kanë kompetencë ekskluzive për ofrimin e shërbimeve të kujdesit dhe ndihmës sociale në territorin e tyre. Konkretisht, bashkitë janë përgjegjëse për:

- Identifikimin e nevojave sociale të komunitetit
- Planifikimin dhe krijimin e shërbimeve të përshtatshme në nivel vendor
- Menaxhimin dhe financimin e shërbimeve
- Monitorimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me standardet kombëtare

Ky rol është i detyrueshëm dhe jo fakultativ, dhe është i lidhur ngushtë me mekanizmin e vlerësimit të performancës së njësive të vetëqeverisjes vendore.

### 3.3.2 Struktura përgjegjëse brenda bashkisë

Neni 36 i Ligjit 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, përcakton qartë përgjegjësitë e bashkive në ofrimin dhe administrimin e shërbimeve sociale në territorin e tyre. Roli i bashkisë është shumëdimensional dhe fillon me identifikimin dhe vlerësimin e nevojave sociale, të cilat realizohen në bazë të hartës së vulnerabilitetit. Këto të dhëna përdoren më pas për të hartuar Planin Social Vendor, një dokument strategjik që përkthen nevojat në politika konkrete shërbimi.

Bashkia është përgjegjëse për programimin e buxhetit vendor dhe për përcaktimin e shportës bazë të shërbimeve shoqërore që duhet të ofrohen për komunitetin. Për realizimin e këtyre shërbimeve, ajo mund të kontraktojë ofrues të jashtëm përmes procedurave të prokurimit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, bashkia ka detyrimin të bashkërendojë punën me Shërbimin Social Shtetëror, për të siguruar që shërbimet të jenë të përputhshme me standardet kombëtare dhe të orientuara drejt nevojave reale të individëve.

Për të garantuar një administrim funksional, ligji parashikon ngritjen e strukturave të posaçme për kujdesin shoqëror brenda vetë bashkisë, si dhe njësi vlerësimi dhe referimi në çdo njësi administrative, në varësi të saj. Gjithashtu, parashikohet që për çdo 6,000 deri në 10,000 banorë të caktohet një punonjës social nga bashkia, për të siguruar mbulimin e duhur dhe përgjigje efektive ndaj nevojave sociale.

Nenet 47 dhe 48 të Ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përcaktojnë funksionimin e strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki dhe rolin kyç të drejtuesit të saj.

Sipas Nenit 47, struktura për shërbimet shoqërore pranë bashkisë ka një mandat të gjerë që shtrihet përtej shërbimeve sociale të zakonshme. Ajo është gjithashtu organi kryesor për çështjet e mbrojtjes së fëmijës, duke ndërmarrë masa nëpërmjet koordinimit me drejtoritë e tjera bashkiake, mekanizmat vendorë të mbrojtjes, dhe institucione të tjera. Kjo strukturë raporton rregullisht kryetarit të bashkisë dhe këshillit bashkiak mbi situatën e fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Një funksion thelbësor i saj është ngritja e grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijës, si në nivel bashkie, ashtu edhe në nivel të njësive administrative, duke koordinoar dhe mbikëqyrur aktivitetet e tij.

Ndërkohë, Neni 48 përcakton detyrat e drejtorit të kësaj strukture, i cili është autoriteti përgjegjës për marrjen e vendimeve mbi masat e mbrojtjes së fëmijëve, bazuar në vlerësimet e punonjësve të mbrojtjes së fëmijës dhe grupit teknik. Drejtori luan një rol kyç në miratimin dhe koordinimin e ndërhyrjeve ndërsektoriale, në zbatim të Planit Individual të Mbrojtjes, si dhe në organizimin e shërbimeve emergjente të mbrojtjes 24-orëshe, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit. Po ashtu, ai është përgjegjës për prokurimin e shërbimeve që nuk mund të ofrohen nga strukturat shtetërore, për monitorimin e aksesit të fëmijëve në të drejta, dhe për raportimin periodik mbi veprimtarinë e njësisë së mbrojtjes së fëmijës.

Referuar Ligjit për barazinë gjinore në Shqipëri, organet e qeverisjes vendore bashkëpunojnë ngushtë me qeverinë qendrore dhe organizatat jofitimprurëse për zbatimin e politikave të barazisë gjinore në territorin që mbulojnë. Ata kryejnë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave lokale të ndara sipas gjinisë dhe emërojnë nëpunës përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore, duke siguruar një mekanizëm efektiv koordinimi dhe monitorimi.

### 3.3.3 Parimet themelore në ofrimin e shërbimeve sociale

Shërbimet shoqërore administrohen në bazë të parimeve universale në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe në mënyrë të veçantë në bazë të këtyre parimeve themelore:

**a) Parimi i universalitetit.** Shërbimet e kujdesit shoqëror janë krijuar, funksionojnë dhe mbikëqyren bazuar në një sistem rregullash ligjore që ofrojnë garanci të mjaftueshme për t'u zbatuar në mënyrë të njëjtë për përfituesit që ndodhen në të njëjtat kushte.

**b) Parimi i drejtësisë sociale.** Çdokush ka detyrim të sigurojë kushtet bazë të jetesës për veten dhe personat, për të cilët ka detyrim ligjor t'i mbështesë dhe çdokush ka detyrim të kontribuojë me punën, të ardhurat dhe pasuritë e tij/saj për reduktimin e gjendjes së varfërisë së tij/saj apo të anëtarëve të familjes, veçanërisht fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë që nuk janë në gjendje të kujdesen për veten e tyre.

**c) Parimi i subsidiaritetit.** Shërbimet e kujdesit shoqëror ofrohen sa më pranë qytetarëve dhe për sa është e mundur nga strukturat vendore.

**ç) Parimi i mbështetjes shoqërore.** Subjektet, të cilat përmbushin kushtet për të përfituar nga shërbimet e kujdesit shoqëror, kanë të drejtën e përdorimit të tyre në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe për aq kohë sa janë në kushtet e vështirësisë e të pamundësisë.

**d) Parimi i deinstitucionalizimit.** Shërbimet e kujdesit shoqëror sigurohen dhe ofrohen, për aq sa është e mundur, pranë familjes ose komunitetit të përfituesit të shërbimit, me qëllim sigurimin e mirëqenies shoqërore dhe përdorimin me efikasitet të fondeve.

**dh) Parimi i partneritetit.** Funksionimi i sistemit të shërbimeve shoqërore bazohet në një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisjes qendrore dhe vendore, si financues kryesorë të shërbimeve shoqërore me organizatat jofitimprurëse dhe subjektet e tjera jopublike, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre ofrimin e shërbimeve shoqërore për individët dhe familjet që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

**e) Parimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe integritetit të përfituesit.** Ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, integritetit të individit, besimit fetar dhe formimin e gjithanshëm të tij.

**ë) Parimi i mosdiskriminimit.** Ndalohet çdo formë e diskriminimit të përfituesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në shkaqet e përmendura në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

**f) Parimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.** Të dhënat personale të individit, që trajtohet me shërbime të kujdesit shoqëror, janë konfidenciale dhe mbrohen e përpunohen sipas ligjit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Punonjësi social, si dhe çdo person tjetër i angazhuar në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror ruan konfidencialitetin e të dhënave personale të individit, subjekt të këtij ligji, për të cilat ka marrë dijeni si pasojë e funksionit

apo detyrës që kryen. Detyrimi për ruajtjen e konfidencialitetit shtrihet edhe pas përfundimit të marrëdhënies së punës, funksionit apo detyrës.

### 3.4 Kategoritë e shërbimeve sociale

Bazuar në ligjet e marra në analizë dhe aktet nënligjore, bashkitë kanë detyrimin të ofrojnë këto lloje të shërbimeve sociale për grupet në nevojë:

*A. Shërbime për fëmijët*




**Dokument referencë:**

- ✓ Ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", sidomos nenet 32-39, që parashikojnë shërbimet për fëmijët në nevojë për mbrojtje, kujdes alternativ dhe përfshirje sociale.
- ✓ Ligjit 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, përcaktojnë detyrimet e bashkive për shërbimet për fëmijët.

- ✓ Udhëzimi nr. 6, datë 27.09.2016, "Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në komunitet", që përfshin standardet për qendrat ditore dhe shërbimet psiko-sociale.

*B. Shërbime për persona me aftësi të kufizuara (PAK)*




**Dokument referencë:**

- ✓ Ligji nr. 93/2014, "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", i cili përcakton të drejtën për shërbime sociale të përshtatura dhe gjithëpërfshirëse në komunitet.
- ✓ Ligjit 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, sidomos nenet 6, 12, 16, 17, 22, 23, që detyrojnë bashkitë të ofrojnë shërbime për PAK sipas standardeve.
- ✓ Udhëzimi nr. 6, datë 27.09.2016, "Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në komunitet", që përfshin standardet për qendrat ditore dhe shërbimet e kujdesit në familje për PAK.
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 6.3.2019, "Për kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për përfitimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për PAK".

*C. Shërbime për të moshuarit*




**Dokument referencë:**

- ✓ Ligjit 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024 përcakton përgjegjësinë e bashkive për ofrimin e shërbimeve për të moshuarit, duke përfshirë kujdesin në banesë dhe strehimin afatgjatë.
- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 425, datë 27.05.2015, "Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në institucione rezidenciale publike dhe jopublike për të moshuarit".
- ✓ Udhëzimi nr. 6, datë 27.09.2016, "Për miratimin e standardeve minimale të shërbimeve në komunitet" – përfshin edhe qendrat ditore dhe shërbimet në banesë për të moshuarit.
- ✓ Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024–2030, e cila thekson zgjerimin e shërbimeve komunitare për të moshuarit, veçanërisht për ata pa mbështetje familjare.
- ✓ Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar – thekson nevojën për mbështetje për shtresat vulnerabël, përfshirë të moshuarit.

*D. Shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit*




**Dokument referencë:**

- Ligj Nr.9669, Datë 18.12.2006 "Për Masa Ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare" ( i ndryshuar)
- VKM Nr. 327, Datë 2.06.2021 "Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës Ndërmjet Autoriteteve Përgjegjëse për Referimin e Rasteve të Dhunës në Marrëdhëniet Familjare, si dhe Procedimin e tij për Mbështetjen e Rehabilitimin e Viktimave eë Dhunës"

### 3.5 Modalitetet e ofrimit të shërbimeve

Shërbimet e kujdesit shoqëror, sipas mënyrës së financimit, klasifikohen në shërbime publike dhe jopublike.

- **Në shërbimet shoqërore publike** përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose në shtëpi. Këto shërbime financohen nga Buxheti i Shtetit dhe nga buxhetet vendore të organeve të qeverisjes vendore.
- **Shërbimet jopublike** klasifikohen në shërbime fitimprurëse dhe jofitimprurëse. Shërbimet shoqërore fitimprurëse nuk mund të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit dhe ai i bashkive. Shërbimet shoqërore jofitimprurëse gëzojnë të drejtën të kërkojnë apo përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit apo ai i bashkive, vetëm nëse kanë lidhur kontratë me subjektin që ka përgjegjësi për të ofruar shërbimin e kujdesit shoqëror. Në shërbimet shoqërore jopublike përfshihen shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendrat rezidenciale, në qendrat ditore ose në shtëpi nga subjekte jopublike.
- **Shërbimet shoqërore të specializuara** janë pjesë e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ofrohen nga ministria përgjegjëse për çështjet sociale dhe nga njësitë e qeverisjes vendore në nivel qarku.

### 3.6 Kërkesa ligjore për profesionistët socialë

Sipas Ligjit nr. 163/2014 "Për urdhrin e punonjësit social" dhe Ligjit 121/2016, "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024, çdo shërbim social duhet të ketë të paktën një punonjës social të licencuar, i cili është përgjegjës për vlerësimin, planifikimin, ndjekjen dhe dokumentimin e ndërhyrjeve. Punonjësit socialë duhet të jenë të diplomuar në fushën përkatëse dhe të kenë licencë aktive nga Urdhri i Punonjësit Social. Në rastin e shërbimeve për fëmijë, përfshihet edhe psikologu me përvojë në çështje të mbrojtjes së fëmijëve.

## 3.7 Qendrat Sociale që ofrojnë Shërbime në Qytetin e Lezhës

- **Qendra e Zhvillimit Ditor**
  Është një qendër ditore e përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara (PAK). Kjo qendër me karakter social-edukativ ofron shërbim për fëmijë dhe të rinj me aftësi të kufizuara me probleme të lehta dhe të mesme me karakter mendor dhe fizik.
- **Qendra "Etërit Rragacionistë Shqiptarë"**
  Është një qendër ditore që ofron shërbime të kujdesit shoqëror për fëmijë nga mosha 6–18 vjeç, si dhe ofron shërbime të programit "After School" për fëmijët e regjistruar.
- **Qendra "Jozue"**
  Është një qendër ditore për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian. Qendra organizon gjithashtu takime me gratë e komunitetit, duke trajtuar tema që ndihmojnë në zhvillimin dhe informimin e tyre për një kujdes më të mirë prindëror.
- **Qendra Rezidenciale "Strehëza Rozalba"**
  Është një qendër rezidenciale për vajza, e cila ofron një sërë shërbimesh për fëmijët e familjeve viktima të dhunës dhe për fëmijët pa kujdes prindëror. Aty fëmijët marrin kujdes të përditshëm nga stafi profesionist dhe ndjekin rregullisht shkollën.
- **Qendra "Malteser"**
  Është një qendër ditore ku ofrohen aktivitete kreative, informuese dhe sensibilizuese, si dhe aktivitete sportive dhe grupi i leximit që organizohet çdo të shtunë. Pjesë e programit ditor janë gjithashtu vlerësimi i rasteve, plotësimi i dokumentacionit, puna në grup dhe individuale me fëmijët, si dhe aktivitete të tjera që trajtojnë tema apo fenomene që ndikojnë negativisht në jetesën e komunitetit. Përfituesit e kësaj qendre janë kryesisht fëmijë të komunitetit rom-egjiptian.
- **Qendra "Karlo Akutis"**
  Është një qendër e licencuar e përkujdesit për fëmijë/djem nga mosha 6–18 vjeç, që ka nisur aktivitetin e saj rreth dy vite më parë. Aktualisht në qendër ndodhen 9 fëmijë rezidentë, të cilët përfitojnë shërbime 24 orë në ditë, gjatë gjithë vitit, pasi shumica prej tyre janë të braktisur nga familjet e origjinës. Qendra nuk funksionon si shërbim emergjent dhe pranon raste të reja vetëm brenda orarit zyrtar, në bazë të kërkesës nga institucionet përkatëse. Stafi është i organizuar në turne të përshtatura sipas nevojave të fëmijëve.
- **Qendra Komunitare Multifunksionale**
  Është një qendër ditore, e përbërë nga staf profesionist, që përfshin psikolog, punonjës social dhe mësues ndihmës për shërbimin "After School". Aktualisht, qendra ofron veprimtari të ndryshme për 25 fëmijë.
- **Shërbimi Lëvizës në Banesë për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara – "Tungjatjeta Jetë"**
  Ky shërbim është një program social që ofron ndihmë të specializuar në banesë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Lezhë. Fëmijët ndiqen në mënyrë individuale në bazë të planeve të zhvillimit të hartuara posaçërisht

për ta, ndërkohë që punohet ngushtësisht edhe me prindërit për të lehtësuar integrimin e fëmijëve në komunitet dhe për të përballuar sfidat sociale.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS) është në vitin e pestë të bashkëpunimit me Bashkinë Lezhë, duke financuar pjesërisht shërbimin nëpërmjet fondit social.

Shërbimi lëvizës ofron terapi për 55 fëmijë (32 djem dhe 23 vajza) në zona të thella të Lezhës. Çdo fëmijë përfiton një seancë javore 60-minutëshe, prej të cilave 45 minuta i kushtohen drejtpërdrejt fëmijës dhe 15 minuta janë të dedikuara për aftësimin e prindit në funksion të terapisë në vijim. Terapitë e ofruara përfshijnë zhvillimin motorik, logopedinë dhe fizioterapinë. Përveç terapive, ofrohet edhe ndihmë materiale dhe mbështetje psiko-sociale për të gjithë familjen e fëmijës.

### 3.8 Prioritetet në zgjerimin e hartës së shërbimeve

**Bashkia Lezhë ka prioritet zgjerimin e hartës së shërbimeve me shërbimet:**



# 4. Analiza e të dhënave- vështrim i përgjithshëm

Sipas të dhënave të përpunuara nga Bashkia Lezhë, janë identifikuar **2,613 individë** të cilët përballen me një ose më shumë forma cenueshmërie sociale dhe për këtë arsye kanë nevojë për ndërhyrje të strukturuar përmes shërbimeve të mbrojtjes apo përkujdesjes sociale. Ky numër përbën **2.2% të popullsisë së përgjithshme** të raportuar në territorin e Bashkisë, megjithatë përqindja reale mund të jetë edhe më e lartë për shkak të ndikimit të migracionit të brendshëm dhe emigracionit ndërkombëtar, që kanë reduktuar ndjeshëm popullsinë aktualisht rezidente në terren.

Kjo përqindje duhet interpretuar në kontekstin e strukturës demografike, nivelit të varfërisë, përhapjes së aftësive të kufizuara, si dhe prirjeve sociale në komunitet. Ajo sinjalizon qartazi një nevojë për shërbime të orientuara drejt përfshirjes sociale, të ndërtuara mbi një qasje gjithëpërfshirëse, me qëllim garantimin e mbështetjes së qëndrueshme për grupet më të pafavorizuara.

Këta individë përfshihen në grupet si:

- persona me aftësi të kufizuara fizike, mendore dhe shqisore;
- fëmijë në rrezik dhe pa kujdes prindëror;
- të moshuar pa përkujdesje;
- familje me të ardhura të pamjaftueshme;
- viktima të dhunës në familje;
- komunitetet romë dhe egjiptianë;
- persona me varësi nga droga ose alkooli.

Për këtë arsye, ky kapitull synon të ofrojë një analizë të thelluar të shpërndarjes gjeografike dhe karakteristikave të çdo grupi, me qëllim që informacioni i mbledhur të shërbejë si bazë për hartimin e planeve të ndërhyrjes, alokimin e burimeve dhe përmirësimin e koordinimit ndërinstitucional në ofrimin e shërbimeve sociale.

### 4.1 Numri i popullsisë sipas gjinisë

Bashkia Lezhë numëron gjithsej **51,354 banorë** të shpërndarë në dhjetë njësi administrative. Struktura demografike tregon një përbërje të balancuar gjinore dhe një shumicë të popullsisë në moshë pune, çka është tregues i një territori me potencial zhvillimi, por që gjithashtu përballet me sfida të plakjes së popullsisë në disa zona rurale.

**Struktura sipas gjinive**

- **Meshkujt** përbëjnë **49.9%** të popullsisë totale (**25,602 banorë**).
- **Femrat** përbëjnë **50.1%** të popullsisë (**25,752 banorë**).




Ky balancim gjinor është i qëndrueshëm në të gjitha njësitë administrative, me një lehtësi dominuese të femrave në zonat urbane si Lezha, Shëngjin dhe Shënkoll.

# 5. Individë në Nevojë për Shërbime dhe Shërbimet Egzistuese

## 5.1 Individë që përfitojnë Ndihmë Ekonomike sipas njësive administrative

Ndihma ekonomike përbën një nga mekanizmat kyç të mbrojtjes sociale në Bashkinë Lezhë, duke synuar të lehtësojë barrën e varfërisë për individë dhe familje në kushte të vështira jetese. Analiza e shpërndarjes së përfituesve në nivel njësish administrative ndihmon në identifikimin e zonave me cenueshmëri të lartë dhe orienton ndërhyrjet prioritare.

### 5.1.1 Familjet përfituese të ndihmës ekonomike

Gjatë periudhës raportuese, për vitin 2024-2025, në Bashkinë Lezhë kanë aplikuar gjithsej **744 familje** dhe individë në nevojë në kategori të ndryshme për përfitimin nga skema e ndihmës ekonomike. Nga këto aplikues , **643 familje në nevojë janë pranuar** si përfituese dhe **56 individë**

**të kategorive të ndryshme** (status jetimi, viktima të dhunës në familje , prindër me më shumë së dy fëmijë të lindur njëherësh, fëmijë të vendosur në familje kujdestare, fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare) . Ndërsa familje nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% , janë gjithsej **86 familje përfituese**.

**Fondi 6% i familjeve përfituese sipas njesive administrative:**

| Njësia Administative | Fondi 6% i familjeve përfituese |
|---|---|
| LEZHË | 19 |
| SHENKOLL | 21 |
| KALLMET | 2 |
| ZEJMEN | 4 |
| BALLDREN | 7 |
| SHENGJIN | 7 |
| UNGREJ | 7 |
| DAJÇ | 6 |
| KOLSH | 11 |
| BLINISHT | 2 |
| TOTAL | **86** |

**Numri i familjeve përfituese nga sistemi i ndihmes ekonomike sipas njesive administrative:**

| Njësia Administative | Numri i familjeve përfituese nga sistemi i ndihmes ekonomike |
|---|---|
| LEZHË | 119 |
| SHENKOLL | 104 |
| KALLMET | 44 |
| ZEJMEN | 87 |
| BALLDREN | 50 |
| SHENGJIN | 24 |
| UNGREJ | 72 |
| DAJÇ | 43 |
| KOLSH | 97 |
| BLINISHT | 59 |
| TOTAL | **699** |




*Përqindja e familjeve përfituese sipas njësive administrative.

### 5.1.2 Struktura sipas gjinisë

Në Bashkinë Lezhë, sipas të dhënave të fundit, rezulton se në skemën e ndihmës ekonomike janë të përfshirë 3,160 individë, të shpërndarë thuajse në mënyrë të balancuar midis gjinive. 1,604 prej tyre janë femra dhe 1,556 janë meshkuj, përkatësisht 50.7% dhe 49.3% e totalit.

Në shikim të parë, kjo përbërje duket e ekuilibruar, por kur këto të dhëna vendosen në raport me strukturën e përgjithshme të popullsisë në territor, dalin në pah disa dallime të rëndësishme dhe domethënëse:

- Popullsia totale e regjistruar përbëhet nga 60,660 meshkuj (51.2%) dhe 57,830 femra (48.8%).
- Ndërkohë, brenda përfituesve të ndihmës ekonomike, raporti gjinor është përmbysur: janë femrat që përfaqësojnë pjesën më të madhe të përfituesve.

Kjo nënkupton se femrat në Bashkinë Lezhë preken më shumë nga varfëria dhe pasiguria ekonomike. Ka disa faktorë të mundshëm që mund të ndikojnë në këtë përfaqësim më të lartë të grave në skemën e ndihmës ekonomike:

1. Struktura familjare – Në shumë raste, ndihma ekonomike përfitohet nga nëna kryefamiljare, sidomos në familjet njëprindërore ose ato ku burri ka emigruar apo është i papunë.
2. Vështirësitë për përfshirje në tregun e punës – Gratë, veçanërisht në zonat rurale, përballen me më shumë barriera për punësim, si:
   - mungesa e aksesit në transport,
   - përgjegjësitë e kujdesit familjar,
   - nivelet më të ulëta të arsimimit dhe trajnimit profesional.
3. Përfshirja në kategori të mbrojtjes së veçantë – Gratë janë më të ekspozuara ndaj kushteve të cenueshmërisë sociale, si: dhuna në familje, barrë e lartë e përkujdesit, ose shëndet i dobët, çka i bën më të pranueshme në skemën e ndihmës ekonomike.

### 5.1.3 Struktura sipas grupmoshave

**Nga 3160 individë që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike dhe fondit 6% :**

- 1211 janë fëmijë (0–18 vjeç)
- 1745janë të rritur në moshë pune (19–64 vjeç)
- 204 janë të moshuar (65+ vjeç)

### 5.1.4 Karakteristikat e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike

Për secilën prej njësive administrative, më poshtë paraqeten në mënyrë të detajuar karakteristikat e familjeve përfituese të ndihmës ekonomike.

| Njësia Administrative | Deri në 2 fëmijë të mitur | Kryefamiljare gra | Të paktën 1 anëtar PAK | Rom/Egjiptian | Të paktën 1 anëtar pensionist |
|---|---|---|---|---|---|
| **Kallmet** | 21 | 4 | 12 | Po | 5 |
| **Blinisht** | 27 | 6 | 15 | Po | 12 |
| **Ungrej** | 26 | 5 | 7 | Po | 14 |
| **Balldren** | 18 | 2 | 14 | Po | 9 |
| **Shënkoll** | 56 | 6 | 9 | 6 raste | 8 |
| **Zejmen** | 16 | 7 | 15 | Po | 8 |
| **Dajç** | 18 | 8 | 5 | Po | 2 |

5.1.5 Punëkërkuesit e papunë në Bashkinë Lezhë

Sipas të dhënave të raportuara nga Zyra Vendore e Punës, në vitin 2025 janë regjistruar **965 individë** si punëkërkues të papunë në territorin e Bashkisë Lezhë. Ky numër përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të popullsisë aktive, që për një sërë arsyesh nuk është e përfshirë në tregun formal të punës.

Të dhënat mbi numrin e punëkërkuesve të regjistruar në Zyrën e Punës, të shpërndarë sipas njësive administrative, ofrojnë një pasqyrë të qartë të përqëndrimit të papunësisë në territorin e Bashkisë Lezhë. Grafiku i mëposhtëm thekson pabarazitë mes zonave dhe ndihmon në identifikimin e prioriteteve për ndërhyrje në politikat aktive të punësimit.




**Lezha urbane përqendron numrin më të lartë të të papunëve:**

- Me **488 punëkërkues të papunë**, njësia administrative e Lezhës zë rreth **50.5%** të totalit prej 965 individësh të regjistruar në Zyrën e Punës. Kjo është një përqendrim shumë i lartë, që lidhet me disa faktorë:
  - Lezha përfshin popullsinë më të madhe dhe urbanizimin më të lartë;

- është qendër e migrimit të brendshëm nga zonat rurale, ku individët shpresojnë të gjejnë më shumë mundësi punësimi;
- përfitimi nga informacioni dhe akses më i lehtë në Zyrën e Punës ka gjasa të jetë më i lartë në qytet se në fshat.

**Zona të tjera me shifra domethënëse, por më të ulëta:**

- **Balldreni** (116 punëkërkues – rreth 12%)
- **Shëngjini** (105 punëkërkues – 11%)
- **Kolshi** (64 punëkërkues – 6.6%)
- **Zejmeni** (69 punëkërkues – 7.2%)

Këto njësi tregojnë për prani të konsiderueshme të papunësisë edhe në zonat jo-urbane dhe turistike (si Shëngjini), duke dëshmuar se zhvillimi sezonal nuk përkthehet automatikisht në punësim të qëndrueshëm.

**Njësi me përqindje shumë të ulëta të të papunëve të regjistruar:**

- **Ungrej** (7 punëkërkues)
- **Blinisht** (23)
- **Dajç** (25)
- **Kallmet** (27)

Këto shifra mund të tregojnë një nivel real më të ulët papunësie, por ka shumë të ngjarë që të pasqyrojnë nën-regjistrim për shkak të mungesës së informacionit, vështirësive në akses apo mosbesimit në efikasitetin e sistemit të ndërmjetësimit për punë.

### 5.1.6 Punëkërkuesit e papunë sipas kategorive

Grafiku i paraqitur jep një pasqyrë të detajuar të grupeve kryesore të individëve të papunë, të regjistruar në Zyrën e Punës në Bashkinë Lezhë. Këto të dhëna pasqyrojnë situatën sociale të papunësisë në territor – një realitet që përfshin gra, burra, minoritete, persona me aftësi të kufizuara dhe individë që jetojnë në kushte të brishta.

Në krye të këtij spektri qëndrojnë **gratë**, me **593 raste të regjistruara**. Ky numër tregon jo vetëm për shkallën e lartë të papunësisë mes grave, por edhe për sfidat e vazhdueshme që ato përballin në përpjekjen për t'u përfshirë në jetën ekonomike. Pavarësisht se shumë prej tyre kanë kapacitet për të punuar, mungesa e mundësive të përshtatshme, përgjegjësitë përkujdesëse dhe mungesa e përkrahjes institucionale i lë jashtë tregut të punës.

Pas tyre, renditen **meshkujt**, me **372 individë** të regjistruar si punëkërkues. Kjo shifër tregon se papunësia në Bashkinë Lezhë nuk është një fenomen që prek vetëm gratë apo grupet vulnerabël – është një problem më i gjerë që përfshin pjesën më të madhe të fuqisë punëtore, pa dallim gjinie.

Një grup që kërkon vëmendje të veçantë është ai i **grave kryefamiljare**, me **131 raste të regjistruara**. Këto janë gra që përballen jo vetëm me papunësinë, por edhe me përgjegjësinë e vetme për mirëqenien ekonomike dhe sociale të familjes. Për këtë kategori, përjashtimi nga tregu i punës është shumë më i rrezikshëm, pasi çon shpesh drejt varfërisë së trashëguar dhe izolimit social.

Në këtë pamje sociale, vend të veçantë zë edhe **komuniteti rom dhe egjiptian**, me **145 punëkërkues të papunë**. Ky është një nga grupet që historikisht përballet me më shumë barriera për punësim të qëndrueshëm dhe përfshirje sociale. Shifrat e regjistrimit tregojnë se ky komunitet ka një prani aktive në kërkimin e punës, por ka nevojë për ndërhyrje më të përshtatura – duke nisur nga trajnimi profesional, deri te mbështetja për vetëpunësim.

Një tjetër grup i pranishëm në këtë pamje janë **personat me aftësi të kufizuara (PAK)** – gjithsej **50 individë të regjistruar si punëkërkues**. Ndonëse numri duket i ulët, ai ngre një pyetje të rëndësishme: a është ky përfaqësim real, apo kemi të bëjmë me mungesë aksesimi të shërbimeve, mosbesim ndaj institucioneve apo mungesë mbështetjeje në procesin e përfshirjes në treg? Kjo kategori kërkon mbështetje specifike, përfshirë ndërmjetësim të dedikuar dhe punësim të asistuar.

Në fund të listës ndodhen **emigrantët e kthyer**, me vetëm **12 individë të regjistruar**. Ky numër është befasues, sidomos në një realitet ku kthimet nga emigracioni janë të shpeshta. Ai mund të jetë tregues i mungesës së një strategjie të qartë për ri-integrimin e kësaj kategorie në jetën ekonomike të vendit.




Aktualisht, janë të regjistruar gjithsej **278 individë** të cilët rezultojnë **si punëkërkues të papunë dhe njëkohësisht përfitojnë ndihmë ekonomike**, sipas të dhënave të marra nga zyrat e punësimit. Ky grup përfaqëson një pjesë të rëndësishme të popullsisë në nevojë, që vuan nga mungesa e të ardhurave të qëndrueshme dhe pamundësia për t'u integruar në tregun e punës. Në të njëjtën kohë, numri i individëve përfitues të ndihmës ekonomike që janë në moshë pune (pra, nga 18 deri në 64 vjeç) arrin në 841. Ky tregues evidenton përmasat e popullsisë aktive që, ndonëse teorikisht në gjendje për të punuar, mbetet e përjashtuar nga mundësitë e punësimit dhe varet nga programet e mbështetjes sociale.

## 5.2 Personat me Aftësi të Kufizuara - Analizë e Shpërndarjes dhe Nevojave

### 5.2.1 Madhësia e Grupit dhe Shtrirja në Territor

Sipas të dhënave të përditësuara nga Bashkia Lezhë, janë evidentuar gjithsej **2060 persona me aftësi të kufizuara** (914 vajza/gra dhe 1146 djem/burra), që i përkasin të gjitha grupmoshave. Kjo shifër përfaqëson një përqindje të konsiderueshme të popullsisë në nevojë për shërbime të dedikuara sociale, shëndetësore dhe rehabilituese. Përveç kësaj kategorie, **2133 individë të tjerë trajtohen përmes skemës së mbrojtjes sociale si invalidë pune** (926 vajza/gra dhe 1207

djem/burra), duke rritur më tej përgjegjësinë institucionale për përfshirjen sociale dhe ekonomike të kësaj shtrese.

Grafiku më poshtë paraqet përqindjen e personave me aftësi të kufizuara dhe individëve të klasifikuar si invalidë pune, të shpërndarë sipas njësive administrative të Bashkisë Lezhë. Ky vizualizim ndihmon për të kuptuar zonat me përqendrim më të lartë të kësaj kategorie dhe shërben si bazë për planifikimin territorial të shërbimeve sociale, rehabilituese dhe ekonomike.




- **Lezha (21%) dhe Shënkolli (19%)** përfaqësojnë zonat me ngarkesën më të madhe të individëve me aftësi të kufizuara apo status invaliditeti, duke i renditur si prioritet për:
    - hapjen ose zgjerimin e qendrave ditore multifunksionale;
    - ofrimin e asistencës në shtëpi;
    - përfshirjen në skemat e punësimit të mbështetur dhe programe të integrimit social.
- **Shëngjini dhe Balldreni** ndjekin me përqindje të konsiderueshme, ndërsa zonat si **Kolshi, Ungreji dhe Blinishti** shfaqin përqindje më të ulëta. Kjo mund të jetë tregues i shpërndarjes më të ulët reale ose, në disa raste, i një nën-raportimi të mundshëm të rasteve.

### 5.2.2 Karakteristikat e Aftesise së Kufizuar

#### 5.2.2.1 Personat me Aftësi të Kufizuara në Shikim

Të dhënat mbi shpërndarjen e personave me aftësi të kufizuara në spektrin e Shikimit ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi përqendrimet gjeografike të kësaj kategorie brenda territorit të Bashkisë Lezhë. Informacioni është klasifikuar sipas njësive administrative dhe ndihmon në orientimin e politikave të ndërhyrjes dhe përmirësimin e aksesit në shërbime të përshtatura.

**Njësia administrative Lezhë** përfaqëson zonën me numrin më të lartë të personave me probleme në shikim (**84 individë, nga të cilët 28 janë vajza/gra dhe 56 djem/burra**), duke përbërë mbi **33%** të rasteve të raportuara në nivel bashkie. Kjo e vendos këtë zonë si prioritet për ndërhyrje strategjike, si sigurimi i mjeteve ndihmëse, orientimi në hapësira publike, mbështetje për përfshirje në arsim dhe punësim.

**Njësitë me përqendrime të konsiderueshme** përfshijnë:

- **Shënkollin** me 39 raste (18 vajza/gra dhe 21 djem/burra),
- **Zejmenin** me 31 raste (16 vajza/gra dhe 15 djem/burra), ,
- **Kolshin** me 22 raste (8 vajza/gra dhe 14 djem/burra),
- **Blinishtin** me 20 raste (14 vajza/gra dhe 6 djem/burra),
- **Shëngjini** dhe **Balldreni** paraqesin shifra mesatare me përkatësisht 18 (6 vajza/gra dhe 12 djem/burra), dhe 15 individë (6 vajza/gra dhe 9 djem/burra),
- **Kallmeti** me 10 raste (5 vajza/gra dhe 5 djem/burra),
- **Dajçi** me 10 raste ( 2 vajza/gra dhe 8 djem/burra)
- **Ungrej** shfaqet me numrin më të ulët – vetëm **5 individë** (1 vajza/gra dhe 4 djem/burra),, që ngre dyshime mbi nën-raportimin ose mungesën e mekanizmave efektivë të identifikimit në zona të thella rurale.

BASHKIA **LEZHË**




### 5.2.2.2 Personat me Aftësi të Kufizuara Para-Tetraplegjik

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen numerike të individëve të identifikuar si persona me aftësi të kufizuara të rënda motorike – konkretisht me para- ose tetraplegji – në nivel njësie administrative brenda Bashkisë Lezhë. Kjo kategori përbën një ndër grupet më të cenueshme, që kanë nevojë për mbështetje intensive dhe të vazhdueshme në jetën e përditshme.

**Të dhënat kryesore të grafikës:**

- **Lezha** kryeson ndjeshëm me **48 raste** (20 vajza/gra dhe 28 djem/burra), duke reflektuar si përqendrimin më të lartë të popullsisë, ashtu edhe ndoshta nivele më të larta të aksesit në shërbime diagnostikuese dhe raportimi të rregullt të rasteve.
- Pas saj vijnë:
  - **Shënkolli** me **32 raste** (13 vajza/gra dhe 19 djem/burra),
  - **Shëngjini** me **23 raste** (6 vajza/gra dhe 17 djem/burra),,
  - **Zejmeni** me **16 raste** (7 vajza/gra dhe 9 djem/burra),, dhe
  - **Kolshi** me **15 raste** ( 6 vajza/gra dhe 9 djem/burra),.
- **Dajçi** dhe **Balldreni** ndjekin me shifra mesatare (13 (5 vajza/gra dhe 8 djem/burra), dhe 12 raste (7 vajza/gra dhe 5 djem/burra),), ndërsa **Kallmeti** ka **9 raste** të raportuara (1 vajza/gra dhe 8 djem/burra).

- **Blinishti** dhe veçanërisht **Ungrej** përfaqësojnë zonat me numrin më të ulët të rasteve – përkatësisht **4** (2 vajza/gra dhe 2 djem/burra), dhe **3 individë** ( 3 djem/burra), çka mund të jetë rezultat i shpërndarjes reale të popullsisë, por edhe i nënidentifikimit të rasteve në zonat më periferike.




5.2.2.3 Personat me Aftësi të Kufizuara Fizike dhe Mendore

Grafiku i mëposhtëm paraqet shpërndarjen numerike të personave me aftësi të kufizuara në spektrin fizik dhe/ose mendor në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Lezhë. Kjo kategori përbën një nga grupet më të mëdha në nevojë për mbështetje sociale dhe përkujdesje të vazhdueshme, duke reflektuar edhe kapacitetin dhe sfidat institucionale për ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse.

**Të dhënat kryesore që dalin nga grafiku:**

- **Lezha** shënon numrin më të lartë, me **460 persona** (191 vajza/gra dhe 269 djem/burra), duke përfaqësuar qendrën kryesore të nevojës për shërbime shëndetësore, rehabilituese dhe mbështetje sociale për këtë kategori. Kjo ngarkesë e lartë mund të lidhet me përqendrimin

më të madh të popullsisë urbane, por edhe me identifikim dhe raportim më të saktë të rasteve.

- **Shënkolli** vjen i dyti me **274 raste** (146 vajza/gra dhe 128 djem/burra), , ndjekur nga **Shëngjini** 158 raste (71 vajza/gra dhe 87 djem/burra)
- **Zejmeni** 156 rate (71 vajza/gra dhe 85 djem/burra),
- **Balldreni** 153 raste (65 vajza/gra dhe 88 djem/burra), duke e vendosur zonën perëndimore të Bashkisë në një pozicion strategjik për zgjerimin e shërbimeve të asistencës në komunitet.
- **Kolshi** 127 raste (57 vajza/gra dhe 70 djem/burra),
- **Kallmeti** 115 raste (60 vajza/gra dhe 55 djem/burra), çka tregon një nivel të mesëm ngarkese, por që kërkon ndërhyrje të qëndrueshme.
- **Dajç** 79 raste (28 vajza/gra dhe 51 djem/burra),
- **Blinisht** 63 raste (33 vajza/gra dhe 30 djem/burra), paraqesin një nivel më të ulët numerik, por gjithsesi të konsiderueshëm për standardet e njësive të vogla.
- **Ungrej** shfaq numrin më të ulët me **46 raste** (21 vajza/gra dhe 25 djem/burra),, çka mund të përfaqësojë ose mungesë të theksuar të shërbimeve, ose nën-raportim të rasteve në zona më të thella dhe rurale.



### 5.2.3 Përfshirja në Arsim e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara

Në aspektin e infrastrukturës, situata paraqitet **relativisht pozitive**, pasi:

- **3 shkolla** dhe **46 kopshte** janë tërësisht të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Megjithatë, përfshirja reale e fëmijëve në këto institucione mbetet e **ulët**:

- Vetëm **31 fëmijë** me aftësi të kufizuara janë të regjistruar në arsimin parauniversitar.
- Vetëm **16 fëmijë** janë të përfshirë në sistemin parashkollor.

Ky kontrast sugjeron se, **pavarësisht përmirësimeve infrastrukturore**, ende ka **pengesa të natyrës sociale, administrative ose psikologjike** që kufizojnë përfshirjen e kësaj kategorie fëmijësh. Këto mund të lidhen me:

- mungesën e transportit të dedikuar,
- mungesën e mbështetjes së duhur pedagogjike,
- ose stigmatizimin shoqëror.

### 5.2.4 Punësimi i Personave me Aftësi të Kufizuara

Nga **22 persona me aftësi të kufizuara** të regjistruar si punëkërkues, janë **punësuar 15** përmes ndërmjetësimit të zyrave të punësimit dhe **5 të tjerë** nga Bashkia. Kjo përfaqëson një **shkallë punësimi prej rreth 91%** për personat aktivë në sistemin e punësimit, çka është një tregues **shumë inkurajues**.

Angazhimi i Bashkisë në punësim përmes politikave përfshirëse tregon vullnet institucional, por **numri i ulët i punëkërkuesve** në regjistër (vetëm 22 në një territor me mbi 2100 PAK gjithsej), mund të nënkuptojë:

- mungesë besimi në sistemin publik të punësimit,

### 5.2.5 Shërbimi i strehimit social

Bashkia Lezhë , ka hartuar planin 5 vjecar të strehimit social (VENDIM Nr. 84, Datë 29. 10. 2024) i cili është i publikuar te ëebsite i bashkisë lezhë, konkretisht tek fusha Kendi i Be-projektet strategjike. Ky plan ka për qëllim të adresojë problemet më emergjente të strehimit për komunitetet më të disavantazhuara, me vëmendje të veçantë në cështjet gjinore, aftësinë e kufizuar e minoritetin Rom e Egjiptian në bashkinë Lezhë brenda periudhës 5-vjeçare, duke u mbështetur në burimet e veta dhe në mbështetjen e financimeve nga Qeverisja Qendrore.

### 5.2.6 Shërbimi Shëndetësor

Shërbimi shëndetësor në Bashkinë Lezhë mbulohet nga **210 profesionistë** (mjekë dhe infermierë) për një popullsi prej **51,354 banorësh**, sipas të dhënave zyrtare të **Censit të Popullsisë dhe**

**Banesave 2023 (INSTAT).** Kjo përkthehet në rreth **1 profesionist për çdo 244 banorë**, një raport që tregon një mbulim më të mirë të shërbimeve mjekësore, por që ende mund të përballet me sfida nëse nuk ka shpërndarje të balancuar gjeografike.
Ky shërbim ofrohet nëpërmjet një rrjeti prej 10 qendrash shëndetësore për të gjithë njesitë administrative e cila përbën bazën e sistemit të kujdesit parësor dhe luan një rol kyç në ofrimin e shërbimeve të vazhdueshme dhe të aksesueshme për komunitetin.

### 5.2.7 Shërbimet zhvilluese dhe rehabilituese sociale

Qendra e Zhvillimit Ditor përfaqëson një nga strukturat më të rëndësishme të shërbimit social në Bashkinë Lezhë, e konceptuar për të ofruar jo vetëm kujdes dhe ndihmë të përditshme për persona me aftësi të kufizuara, por edhe për të nxitur **zhvillimin personal, social dhe emocional** të tyre. Ajo funksionon si një **hapësirë mbështetëse dhe gjithëpërfshirëse**, ku individët me nevoja të veçanta marrin shërbime të specializuara në përputhje me gjendjen dhe potencialet e tyre.
Në këtë qendër, aktualisht marrin shërbim **35 përfitues**, të cilët janë të angazhuar rregullisht në një **kombinim shërbimesh të ndërthurura**, që shkojnë përtej asistencës bazike dhe synojnë të fuqizojnë individin në mënyrë funksionale dhe sociale.
**Gama e shërbimeve të ofruara përfshin:**

- **Logopedi dhe ortofoni**, për zhvillimin e gjuhës dhe aftësive të komunikimit.
- **Fizioterapi dhe pedagogji**, për përmirësimin e lëvizshmërisë, zhvillimin kognitiv dhe vetë-menaxhimin e funksioneve ditore.
- **Trajtime dhe mbështetje psikosociale**, për të adresuar çështje emocionale, të sjelljes apo të përfshirjes në komunitet.
- **Shërbim ushqimor me dy vakte në ditë**, që mbulon një nevojë bazike jetike për përfituesit, duke rritur sigurinë ushqimore për ta.
- **Aktivitete social-kulturore**, që jo vetëm argëtojnë, por edhe ndërtojnë ndjenjën e përkatësisë, zhvillojnë aftësi sociale dhe përfshirje kulturore.

Qendra menaxhohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga përfaqësuesi i Bashkisë Lezhë, i cili ka përgjegjësinë për të **mbikëqyrur funksionimin e përditshëm**, të garantojë që shërbimet të ofrohen me **cilësi, profesionalizëm dhe respekt për dinjitetin e përfituesve**, dhe të sigurojë që stafi të jetë i trajnuar dhe i ndjeshëm ndaj nevojave të individëve me aftësi të kufizuara.

Prania e një qendre të tillë ka ndikim shumëdimensional:

- **Familjarët lehtësohen nga barra e kujdesit të përditshëm**, duke pasur mundësi të angazhohen në punë ose veprimtari të tjera.
- **Përfituesit zhvillojnë aftësi të reja**, ruajnë ose përmirësojnë funksionet ekzistuese dhe përfshihen më mirë në jetën komunitare.

- **Reduktohet izolimi social** dhe rritet ndjenja e vetëvlerësimit tek individët me aftësi të kufizuara.

6. Viktima të dhunës në familje

Dhuna në familje mbetet një nga sfidat më serioze të mbrojtjes sociale në Bashkinë Lezhë. Në total në Bashkinë Lezhë janë trajtuar 91 raste të viktimave të dhunës në familje, nga të cilat 67 janë vajza/gra dhe 24 djem/burra. Të dhënat e raportuara janë të ndara sipas njësive administrative dhe përfaqësojnë rastet e identifikuara e të trajtuara nga strukturat vendore përkatëse gjatë periudhës së monitorimit.

- **Lezha** paraqitet me ndjeshëm numrin më të lartë të rasteve të dhunës në familje (**62 raste** , ose mbi 50% e totalit të raportuar), duke e pozicionuar si zonën më të ekspozuar ndaj kësaj problematike. Kjo kërkon forcimin e mekanizmave vendorë të referimit dhe ofrimin e mbështetjes së menjëhershme për viktimat (strehim, këshillim, ndihmë ligjore).
- **Shënkolli** dhe **Shëngjini**, me **13** dhe **11 raste** përkatësisht, sinjalizojnë gjithashtu një përhapje të konsiderueshme të dhunës në familje në zonat gjysmë-urbane, duke sugjeruar nevojën për ndërhyrje të fokusuara në komunitet dhe bashkëpunim më të ngushtë me shkollat, qendrat shëndetësore dhe policinë lokale.
- **Zejmeni, Kallmeti, Balldreni, Dajçi dhe Kolshi**, me nga **3 deri në 6 raste**, tregojnë një prezencë të moderuar të fenomenit, që mund të jetë realisht më e lartë, por e nën-raportuar për shkak të mungesës së informacionit, frikës nga stigmatizimi apo mosfunksionimit të rrjetit të referimit.
- **Blinishti** me vetëm **1 rast** dhe **Ungreji** me **0 raste** të raportuara, duhet të konsiderohen zona ku ka gjasa të ketë raste të pazbuluara. Ato përbëjnë prioritete për ndërgjegjësim dhe trajnime komunitare.




6.1 Shërbimet e ofruara për viktimat e dhunës në familje në Bashkinë Lezhë

Në përputhje me angazhimet institucionale për mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, Bashkia Lezhë ka ndërtuar një paketë shërbimesh që synon të garantojë trajtim gjithëpërfshirës dhe të ndërsektorial për individët që përballen me këtë formë të dhunës.

Shërbimet e ofruara përfshijnë aspekte bazike të mbijetesës, si dhe mbështetje për rikthim në jetë aktive dhe të pavarur. Konkretisht, paketa përmban:

- **Ndihmë Ekonomike** – Sigurimi i mbështetjes financiare për viktimat dhe familjet e tyre, veçanërisht kur humbja e të ardhurave është pasojë e dhunës apo largimit nga ambienti familjar.
- **Strehim Social** – Mundësi për vendosje të përkohshme apo të qëndrueshme për viktimat që nuk mund të qëndrojnë më në banesën ku janë dhunuar, duke garantuar siguri dhe privatësi.
- **Punësim dhe aktivizim ekonomik** – Përpjekje për përfshirje të viktimave në tregun e punës, përmes ndërmjetësimit me Zyrën e Punës, nxitjes së vetëpunësimit ose mbështetjes me trajnime profesionale.

- **Këshillim psikologjik dhe ligjor** – Shërbime për përballimin e traumës, rikuperimin emocional dhe orientimin ligjor, përfshirë ndihmën në procesin e sigurimit të urdhrave të mbrojtjes apo përfaqësimit në procedura gjyqësore.
- **Shërbime emergjente** – Ndërhyrje të menjëhershme në raste të dhunës së përsëritur apo në rrezik për jetën, në bashkëpunim me policinë, strukturat e mbrojtjes sociale dhe qendrat shëndetësore.
- **Shërbime për fëmijët e viktimave** – Mbështetje psiko-sociale për fëmijët e prekur nga dhuna në familje, përfshirë akses në arsim, shërbime kujdesi, këshillim dhe rehabilitim emocional.
- **Strehim emergjent dhe afatëgjatë** për viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre.
- **Shërbim shëndetësor**.

Paketa e shërbimeve e zbatuar nga Bashkia Lezhë tregon një qasje të integruar dhe të ndjeshme ndaj situatës së viktimave të dhunës në familje. Megjithatë, për të qenë efektive, këto shërbime duhet të shoqërohen me:

- rritje të kapacitetit profesional të stafit vendor,
- rritje të koordinimit ndërinstitucional,
- dhe zhvillim të mekanizmave për identifikim të hershëm, raportim të sigurt dhe ndjekje të qëndrueshme të rasteve.

### 6.2 Mekanizmi i Referimit për rastet e dhunës në familje në Bashkinë Lezhë

Bashkia Lezhë ka vendosur një angazhim të strukturuar dhe ligjor për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, përmes ngritjes dhe funksionalizimit të **Mekanizmit të Referimit (MKR)**. Ky mekanizëm ndërinstitucional siguron bashkërendimin e të gjitha institucioneve përgjegjëse për parandalimin, identifikimin, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave.

Mekanizmi i Referimit në Lezhë është themeluar formalisht më 26.11.2018, përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nga Komiteti Drejtues Vendor, dhe më pas është rinovuar dhe përditësuar më datë 06.12.2021, në përputhje me ndryshimet ligjore të miratuara me VKM nr. 327/2021.

Ky funksionim bazohet në kuadrin kombëtar për mbrojtjen nga dhuna në familje, konkretisht:

- **Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006**, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar,
- dhe **Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 16.6.2021**, "Për Mekanizmin e Bashkërendimit të Punës ndërmjet Autoriteteve Përgjegjëse për Referimin e Rasteve të Dhunës në Familje".

MKR Lezhë operon mbi bazën e **bashkëpunimit ndërsektorial**, duke përfshirë aktorë nga:

- Shërbimet sociale të bashkisë,
- Policia e Shtetit,
- Zyrat e ndihmës juridike falas,
- Shëndetësia vendore,
- Drejtoria Arsimore Rajonale,
- Prokuroria dhe gjykatat,
- Organizata të shoqërisë civile.
- Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
- Agjensia Kombëtare e Punësimit
- Prefekti i Qarkut
- Këshilli i Qarkut
- Fondacioni Mary Ëard Loreto
- Strehëza për Gra dhe Vajza, Tiranë
- Qendra Rinore Motrat Venerini, Strehëza Emergjente Venerini

Ky bashkërendim ka ndihmuar në:

- menaxhimin e integruar të rasteve të dhunës në familje,
- rritjen e efikasitetit të ndërhyrjeve, duke shmangur fragmentimin institucional,
- dhe më e rëndësishmja, fuqizimin e viktimave përmes qasjes së koordinuar, gjithëpërfshirëse dhe të bazuar në të drejtat e njeriut.

**Zhvillimi i kapaciteteve profesionale**

Në kuadër të funksionimit të Komitetit Drejtues (KD) i Mekanizmit të Koordinuar të Referimit MKR, është vendosur në fokus edhe **rritja e kapaciteteve të Ekipit Teknik Ndërdisiplinar (ETN)** dhe **Komitetit Vendor (KV)**. Për këtë qëllim, janë organizuar **trajnime të specializuara dhe të përsëritura**, të cilat kanë rritur aftësinë e stafit për:

- identifikimin në kohë të rasteve,
- ndërtimin e planeve të ndërhyrjes të personalizuara,
- dhe ndjekjen e monitorimin e rasteve deri në rehabilitim të plotë.

## 7.Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale

### 7.1 Të moshuarit në nevojë për shërbime sociale sipas njësive administrative

Të dhënat e paraqitura në grafikun e mësipërm evidentojnë **shpërndarjen e pabarabartë territoriale** të të moshuarve që kanë kërkuar mbështetje nga strukturat sociale në nivel vendor. Në total, janë identifikuar **250 të moshuar**, por përqendrimi i tyre ndryshon ndjeshëm nga një njësi administrative në tjetrën.

Me **181 të moshuar** në nevojë , njësia Lezhë përfaqëson **mbi 72% të totalit**, duke e pozicionuar si zonën me përqendrimin më të lartë të kërkesës për shërbime sociale. Kjo mund të shpjegohet me faktorë si:

- përqendrimi urban dhe numri më i lartë i popullsisë së moshuar,
- vetmia dhe mungesa e përkrahjes familjare në zonat urbane,
- akses më i lehtë në informacion dhe strukturat mbështetëse.

Pas Lezhës, vijnë **Kolshi (20 të moshuar)** dhe **Shëngjini (19 të moshuar)**. Këto zona paraqesin nevojë të moderuar për mbështetje, duke sugjeruar ekzistencën e një grupi të moshuarish që kërkojnë ndihmë të rregullt, ndonëse jo në nivele kritike.

- **Blinisht (12 raste), Shëngjin (19 raste), Kolsh (20 raste)**, dhe **njësitë si Kallmet, Dajç, Balldren, Zejmen** (me 2–5 raste secila) paraqiten me shifra më të ulëta, të cilat mund të interpretohen si:
    - nevojë më e ulët reale për shërbime,
    - ose kufizim në identifikimin dhe raportimin e rasteve, sidomos në zona më të thella rurale.




7.2 Shërbimet e kujdesit shoqëror për të moshuarit

Grafiku më poshtë, paraqet strukturën e nevojave për **mbrojtje dhe përkujdesje sociale** të të moshuarve në Bashkinë Lezhë, të ndarë sipas llojit të shërbimit të kërkuar. Nga 250 të moshuar të identifikuar si në nevojë, shpërndarja tregon një llojshmëri kërkesash, duke theksuar rëndësinë e një qasjeje të personalizuar dhe gjithëpërfshirëse në kujdesin social.

**1. Shërbimi më i kërkuar – Qendra Ditore (60 persona total, nga të cilët 15 gra dhe 45 burra)**
Kategoria më e madhe e të moshuarve (**41% e totalit**) ka shprehur nevojë për **shërbime në qendër ditore**. Kjo nënkupton kërkesë për:

- aktivitete socializuese dhe argëtuese,
- mbështetje psikosociale,
- përkujdesje ditore me qasje profesionale.

Kërkesa për qendra të tilla dëshmon se shumë të moshuar janë ende funksionalë, por kërkojnë përfshirje sociale dhe mbështetje në përditshmëri.

**2. Përfitues të ndihmës ekonomike (70 persona)**
Rreth **28%** e të moshuarve varen nga **ndihma ekonomike** për mbijetesën e tyre. Kjo tregon varfëri të theksuar dhe mungesë të burimeve alternative të të ardhurave, si pensioni i mjaftueshëm ose ndihma familjare.

**3. Shërbim në familje (56 persona total nga të cilët 42 gra dhe 14 burra)**
Një pjesë e konsiderueshme (**22%**) ka kërkuar **shërbim në familje**, që përfshin ndihmë me higjienën, ushqimin, shoqërinë apo mbështetjen emocionale në vendbanimin e tyre. Ky tregues është veçanërisht i rëndësishëm për të moshuarit që jetojnë vetëm ose kanë aftësi të kufizuara.

**4. Kërkesa për strehim social (16 persona total nga të cilët 9 gra dhe 7 burra)**
Një pjesë e të moshuarve përballen me **mungesë të banesës** ose kushtet e papërshtatshme për të jetuar të vetëm. Kërkesa për strehim social përfaqëson një **kategorinë më të brishtë**, shpeshherë të izoluar ose pa rrjet familjar mbështetës.

**5. Shërbim rezidencial (6 persona total nga të cilët 2 gra dhe 4 burra)**
Kërkesa për **kujdes të vazhdueshëm 24/7** në një qendër rezidenciale ka ardhur nga **6 të moshuar** (2% e totalit). Kjo tregon prani të rasteve me varësi të lartë nga përkujdesja intensive për shkak të shëndetit apo gjendjes psiko-sociale.

Të dhënat përforcojnë nevojën për ndërtimin e një sistemi të diversifikuar dhe fleksibël shërbimesh për moshën e tretë, duke garantuar:

- Qasje të personalizuar, në varësi të gjendjes shëndetësore dhe sociale;
- Zgjerim të qendrave ditore dhe shërbimeve në familje si forma më të kërkuara;
- Mbështetje për strehim dhe shërbime rezidenciale për rastet më të rënda.




Me uljen e vazhdueshme të lindshmërisë dhe rritjen e jetëgjatësisë, përqindja e të moshuarve në popullatë po rritet ndjeshëm çdo vit. Ashtu si fëmijët, edhe të moshuarit kanë nevojë për shërbime të specializuara dhe struktura multidisiplinare që adresojnë nevojat e tyre fizike, emocionale dhe sociale.

Përballë kësaj dinamike demografike, sfida profesionale qëndron në garantimin e një pleqërie të shëndetshme dhe dinjitoze përmes ofrimit të shërbimeve të integruara të përkujdesjes shoqërore dhe shëndetësore. Në këtë drejtim, **Qendra Multidisiplinare për Moshën e Tretë**, e vendosur në qytetin e Lezhës, përfaqëson një praktikë të mirë funksionale. Kjo qendër operon në kuadër të bashkëpunimit ndërmjet **Bashkisë Lezhë dhe Kryqit të Kuq Shqiptar**, duke ofruar mbështetje për të moshuarit nëpërmjet aktiviteteve sociale, këshillimit, kujdesit ditor dhe ndërhyrjeve të personalizuara, në përputhje me nevojat individuale.

## 8. Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

### 8.1 Madhësia e grupit dhe shtrirja në territor

Në territorin e Bashkisë Lezhë, çështja e mbrojtjes së fëmijëve mbetet një ndër prioritetet më të ndjeshme të politikës sociale lokale. Bazuar në të dhënat më të fundit të grumbulluara nga strukturat përkatëse, janë identifikuar gjithsej **141 fëmijë** ( 83 djem dhe 58 vajza) që gjenden në situata cenueshmërie dhe kanë nevojë për të paktën **një formë mbrojtjeje apo përkujdesjeje sociale.** Ky raport pasqyron një përqindje më të lartë të djemve në situata që kërkojnë ndërhyrje të strukturave të mbrojtjes së fëmijëve. Faktorët që ndikojnë në këtë diferencë mund të lidhen me tipologjinë e rasteve, natyrën e shkeljeve apo rreziqeve që hasin djemtë dhe vajzat, si dhe me mënyrën e raportimit dhe identifikimit të rasteve nga komuniteti dhe institucionet. Ky tregues nënvizon nevojën për analiza të mëtejshme mbi shkaqet strukturore dhe sociale që ndikojnë në ekspozimin e fëmijëve ndaj riskut, duke marrë në konsideratë dallimet gjinore në përjetimin dhe përballjen me situatat e cenueshmërisë.

Ky numër përfaqëson një tregues domethënës për nivelin e rrezikut social që përballojnë fëmijët në territor dhe tregon për **nevojën urgjente për ndërhyrje të qëndrueshme dhe të koordinuara** nga strukturat publike dhe partnerët institucionalë e komunitarë.

Rastet janë të shpërndara në mënyrë të pabarabartë midis njësive administrative të Bashkisë, duke reflektuar jo vetëm faktorë demografikë dhe socialë, por edhe kapacitetin e strukturave vendore për të identifikuar dhe adresuar rastet në kohë.

Fëmijët e evidentuar përballen me një gamë të gjerë problemesh, përfshirë:

- mungesën e kujdesit prindëror, për shkak të braktisjes, emigracionit, vdekjes së prindërve ose prindërimit të paaftë;
- ekspozimin ndaj dhunës në familje apo në komunitet;
- punën e fëmijëve, në formën e shfrytëzimit ekonomik apo përfshirjes në aktivitete të rënda për moshën;
- mungesën e ndjekjes së rregullt të arsimit;
- si dhe probleme të shëndetit fizik dhe mendor, të pambështetura me shërbime përkatëse.

Grafiku i mëposhtëm paraqet përqindjen e fëmijëve të identifikuar si në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje, të ndarë sipas njësive administrative të Bashkisë Lezhë. Nga të dhënat vizuale kuptohet qartë se shpërndarja territoriale është jo e barabartë, me diferenca të theksuara në përqendrim dhe identifikim të rasteve.

Qyteti i Lezhës mban peshën më të madhe të rasteve të identifikuara, me **50% të totalit të fëmijëve në nevojë për mbrojtje**. Kjo mund të lidhet me disa faktorë të ndërthurur:

- prani më e madhe e popullsisë urbane dhe e strukturave të shërbimeve sociale që identifikojnë dhe referojnë rastet;

- ndërlikime më të mëdha sociale dhe familjare në zona urbane, përfshirë emigracionin, papunësinë, dhunën në familje, etj.;
- një nivel më i lartë ndërgjegjësimi dhe raportimi në qytet sesa në zona rurale.

Pas Lezhës, tri njësi shfaqen me përqindje të barabartë prej **9%**: **Balldreni, Kolshi dhe Shëngjini**, që përfaqësojnë zona me kombinim të karakterit rural dhe gjysmë-urban. Këto zona tregojnë **prezencë të qëndrueshme të rasteve**, ndonëse në nivele më të ulëta se qendra urbane, por që kërkojnë një vëmendje të shtuar për shkak të potencialit për nënraportim.

Njësi të tjera si:

- **Shënkolli (7%)**,
- **Zejmeni dhe Kallmeti (nga 6%)**,
- **Blinishti (3%)**,
- **Dajçi (2%)**, dhe
- **Ungrej (1%)**

paraqesin përqindje dukshëm më të ulëta. Kjo shpërndarje jo domosdoshmërisht nënkupton mungesë të fëmijëve në situata risku, por më shumë **vështirësi në identifikim**, mungesë raportimi, apo akses të dobët në shërbime sociale.

BASHKIA **LEZHË**

Shpërndarja e fëmijëve në nevojë për mbrojtje sipas njësive administrative në Bashkinë Lezhë




## 8.2 Fëmijë në Nevojë për Mbrojtje, me Aftësi të Kufizuara

Të dhënat mbi fëmijët me aftësi të kufizuara të cilët janë njëkohësisht në nevojë për mbrojtje janë tepër të ulëta, si në numër absolut ashtu edhe në shpërndarjen territoriale. Sipas informacionit të mbledhur në Bashkinë Lezhë, vetëm dy raste janë evidentuar në të gjithë territorin:

| Njësia Administrative | Nr. i rasteve |
|---|---|
| **Kolsh** | 1 (djalë) |
| **Shëngjin** | 1 (vajzë) |
| **Të gjitha njësitë e tjera** | 0 |

Këto të dhëna **nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht realitetin**, por ngrenë shqetësime të rëndësishme për **mungesën e identifikimit sistematik** të fëmijëve me aftësi të kufizuara që mund të jenë viktima të dhunës, neglizhimit apo përjashtimit social.

Numri i ulët i raportimeve sugjeron një **nën-raportim të theksuar**, që mund të ndikohet nga:

- mungesa e ndërgjegjësimit në komunitet dhe familje;
- stigmatizimi i dyfishtë (aftësi e kufizuar + viktimë);
- mungesa e bashkëpunimit praktik ndërmjet shkollave, qendrave shëndetësore dhe strukturave të mbrojtjes së fëmijës.

### 8.3 Shërbimet për fëmijët në Bashkinë Lezhë

Bashkia Lezhë ka ndërtuar një infrastrukturë institucionale për ofrimin e shërbimeve të ndryshme në mbështetje të fëmijëve, me synim garantimin e mbrojtjes, përkujdesjes, edukimit dhe zhvillimit të tyre të gjithanshëm. Këto shërbime përfshijnë ndërhyrje në fushën sociale, arsimore dhe të përkujdesjes së hershme, duke synuar të adresojnë nevojat e fëmijëve në të gjitha fazat e zhvillimit.

**Shërbimet sociale – Qendra e Zhvillimit Ditor**

Në territorin e Bashkisë funksionon një **Qendër Zhvillimi Ditor**, e cila ofron një paketë të plotë shërbimesh për fëmijët me nevoja të veçanta për përkujdesje dhe rehabilitim. Aktualisht, kjo qendër i shërben **35 përfituesve** (9 vajza/gra dhe 26 djem/burra), të cilët marrin mbështetje të rregullt në përputhje me nevojat e tyre specifike.

Shërbimet që ofrohen në qendër përfshijnë:

- Logopedi, fizioterapi dhe ortofoni për zhvillimin funksional dhe verbal të fëmijëve;
- Pedagogji specializuar dhe mbështetje psikosociale;
- Trajtime të vazhdueshme rehabilituese, si dhe
- Shërbim ushqimor me dy vakte në ditë dhe aktivitete social-kulturore për përfshirjen sociale dhe zhvillimin e përgjithshëm.

Qendra menaxhohet nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë Lezhë, të cilat mbikëqyrin funksionimin e përditshëm dhe sigurojnë ofrimin e shërbimeve në mënyrë cilësore, gjithëpërfshirëse dhe me qasje të personalizuar.

8.4 Shërbimi i Kujdesit për Fëmijët e Moshës 0–3 vjeç (Çerdhja)

Në territorin e Bashkisë Lezhë janë në funksion 7 çerdhe, ndër të cilat 1 është shtetërore dhe 6 private, të cilat u shërbejnë fëmijëve të moshës 0–3 vjeç. Aktualisht janë të regjistruar 288 fëmijë (146 vajza dhe 142 djem), të cilëve u ofrohen shërbime përkujdesjeje, edukimi të hershëm dhe ushqim të kontrolluar, në përputhje me standardet e çerdheve publike.

## 9.Familjet rome dhe egjiptiane

### 9.1 Madhësia e grupit dhe shtrirja në territor

Të dhënat e siguruara nga Bashkia Lezhë tregojnë një prani të konsiderueshme të komuniteteve rome dhe egjiptiane në territorin e saj, me një shpërndarje territoriale të përqendruar në disa njësi administrative.

Konkretisht, në territorin e Bashkisë janë identifikuar 74 familje rome, me një numër total prej 336 banorësh. Përqendrimi më i madh është në njësinë administrative Lezhë, me 54 familje (73%) dhe 300 banorë romë. Kjo njësi përfaqëson pikën më të madhe të grumbullimit të këtij komuniteti dhe si e tillë kërkon një fokus të veçantë në politikat sociale, programet e integrimit dhe qasjen gjithëpërfshirëse në shërbime.

Shënkolli përbën njësinë e dytë me prani të familjeve rome, ku janë identifikuar 20 familje me gjithsej 36 banorë. Në të gjitha njësitë e tjera administrative (Balldren, Blinisht, Dajç, Kallmet, Kolsh, Shëngjin, Ungrej, Zejmen), nuk rezultojnë të ketë familje apo banorë të komunitetit rom, çka mund të reflektojë ose mungesën faktike të këtij komuniteti ose nevojën për përmirësim të proceseve të identifikimit dhe raportimit.

Nga ana tjetër, komuniteti egjiptian paraqitet me një përmasë edhe më të madhe. Në total janë regjistruar 400 familje egjiptiane, me 1189 banorë. Pjesa më e madhe është përqendruar në njësinë administrative Lezhë, me 300 familje dhe 900 banorë, ndjekur nga Shëngjini me 60 familje dhe 200 banorë, dhe Shënkolli me 40 familje dhe 89 banorë.

Në të gjitha njësitë e tjera administrative, nuk ka të dhëna për praninë e komunitetit egjiptian. Kjo shpërndarje evidenton një përqendrim të dukshëm në zonat urbane dhe ato me akses më të mirë në shërbime publike.

### 9.2 Shërbimet për familjet rome dhe egjiptiane

Bashkia Lezhë ofron për këto komunitete një sërë shërbimesh sociale dhe mbështetëse, përfshirë:

- Ndihmë ekonomike dhe përfshirje në skemën e aftësisë së kufizuar (PAK),
- Mbështetje për strehim social,
- Pjesëmarrje në programe si "after school" dhe aktivitete për prindërim pozitiv,
- Aktivizim në qendrat komunitare multifunksionale, të cilat luajnë një rol kyç në integrimin dhe fuqizimin e këtyre komuniteteve në jetën sociale, ekonomike dhe arsimore.

Të dhënat e paraqitura nënvizojnë qartë nevojën për një qasje të orientuar drejt zonave me përqendrim të lartë të komuniteteve rome dhe egjiptiane, duke forcuar infrastrukturën sociale, duke

BASHKIA LEZHË

mundësuar akses të barabartë në arsim, shëndetësi dhe strehim, si dhe duke ndërtuar ura besimi përmes ndërhyrjeve të qëndrueshme e të koordinuara ndërinstitucionale.



## 10.Personat me varësi nga droga dhe nga alkooli

### 10.1 Madhësia, karakteristikat e grupit dhe shtrirja në territor

Përkundër mungesës së rasteve të raportuara zyrtarisht nga Policia dhe strukturat vendore të Bashkisë për persona me varësi nga droga apo alkooli (të cilët rezultojnë 0 në regjistrat lokalë), ekzistenca e 5 individëve që marrin aktualisht trajtim me metadon tregon se problemi është real, por **nuk evidentohet apo raportohet mjaftueshëm në nivel vendor**.

Kjo mund të reflektojë dy fenomene:

1. Stigmatizimi social dhe mungesa e raportimit vullnetar nga vetë individët apo familjarët;
2. Procedura të centralizuara të trajtimit dhe vlerësimit, që i bëjnë këto raste të menaxhohen nga struktura qendrore të Ministrisë së Shëndetësisë, duke i lënë jashtë sistemit lokal të informacionit dhe statistikave.

Nga ana tjetër, Bashkia ka identifikuar disa shërbime të kujdesit shoqëror që targetojnë këtë kategori, duke përfshirë:

- Fuqizim ekonomik dhe mbështetje për punësim,
- Rehabilitim përmes këshillimi psikologjik falas, që janë mjete të rëndësishme për rikuperimin dhe integrimin e këtyre individëve në shoqëri.

Ky boshllëk midis realitetit të trajtimit dhe raportimit zyrtar thekson nevojën për forcimin e mekanizmave të referimit vendor, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për të çliruar këtë temë nga tabutë dhe për ta trajtuar si një çështje të shëndetit publik dhe jo vetëm të rendit apo moralit.

## 11. Shërbimet Bazë që ofron Bashkia Lezhë

**Referuar standardeve minimale kombëtare pushteti vendo duhet të ofrojë:**

1. Shërbime për fëmijët dhe familjet

- Identifikimi dhe menaxhimi i rasteve të rrezikut për fëmijët (në përputhje me Ligjin 18/2017)
- Mbështetje psiko-sociale për fëmijë dhe prindër
- Shërbime për parandalimin e braktisjes dhe përkujdes alternativ (streha, kujdestari, birësim)
- Përfshirje në procesin e mbrojtjes dhe edukimit të hershëm

2. Shërbime për personat me aftësi të kufizuara (PAK)

- Asistencë në shtëpi / kujdes personal (home-based services)
- Qendra ditore për integrim social dhe zhvillim
- Shërbime për mbështetje në arsim, punësim dhe lëvizshmëri
- Referim për vlerësim funksional dhe plane individuale mbështetëse

3. Shërbime për të moshuarit

- Shërbime të kujdesit në shtëpi (home-care)
- Aktivitete sociale dhe interaktive në qendra komunitare
- Identifikimi i të moshuarve të vetmuar dhe ndihmë për nevojat bazike

4. Shërbime për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

- Shërbime të menjëhershme mbështetëse (psikolog, jurist, transport)
- Referim në strehë të mbrojtura ose qendra emergjente
- Këshillim për rindërtim të jetës dhe pavarësi ekonomike
- Koordinimi i rasteve përmes mekanizmit të referimit

5. Shërbime për persona në situatë rreziku social

- Qendra komunitare multifunksionale (për fëmijë, të rinj, gra)
- Strehim emergjent për persona të pastrehë
- Shërbime për përdorues të substancave apo persona me çrregullime mendore
- Ndihmë për të dalë nga varfëria ekstreme dhe integrim në komunitet

6. Shërbime të koordinimit dhe menaxhimit të rasteve

- Zyrë e shërbimit social në bashki, me punonjës social dhe psikolog
- Regjistër i rasteve, sistem i dokumentimit dhe raportimit
- Ndërtimi i planit individual të ndërhyrjes për çdo rast
- Monitorim dhe ndjekje periodike

**Bashkia Lezhë ka funksionale:**

| Shërbimi | Forma minimale | Burimi Ligjor | Po/Jo/Pjesërisht |
|---|---|---|---|
| **Zyrë shërbimesh sociale** | 1 PS + 1 Psikolog | Ligji 121/2016 | Jo |
| **Menaxhim rastesh për fëmijë** | Mekanizëm referimi | Ligji 18/2017 | Po |
| **Shërbim për PAK** | Qendër ditore ose home-care | VKM 1074/2015 | Qender ditore |
| **Mbështetje për të moshuar** | Vizita shtëpie ose klub social | VKM 821/2006 | Pjeserisht |
| **Ndihmë për viktimat e dhunës** | Strehë, referim, psikolog | Ligji 9669/2006 | Po |
| **Rrjet referimi vendor** | Strukturë ndërsektoriale | Udhëzim nr. 10/2018 | Po |

| Bashkia | Shërbimet funksionale në Bashki |
|---|---|
| **Lezhë** | ✓ shërbimet parashoqërore;<br>✓ shërbimet në qendrat komunitare, përfshirë qendrat e zhvillimit;<br>✓ shërbimet në qendrat rezidenciale, përfshirë strehëzat;<br>✓ shërbimet shoqërore në situatë emergjence;<br>✓ shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror; |

| Fusha e Shërbimit | Aktualisht ekziston? (Po/Jo) |
|---|---|
| **Zyrë e shërbimit social me staf të kualifikuar** | Po |
| **Menaxhim i rasteve të fëmijëve në risk** | Po |
| **Shërbime për personat me aftësi të kufizuara (PAK)** | Po |
| **Shërbime për të moshuarit** | Po |
| **Shërbime për viktimat e dhunës në familje** | Po |
| **Qendra komunitare për grupe vulnerabël** | Po |
| **Strehim emergjent për persona në nevojë** | Po |
| **Shërbime për përdorues të substancave ose me çrregullime mendore** | Jo |
| **Sistem dokumentimi dhe ndjekje e rasteve** | Po |
| **Rrjet referimi ndërsektorial vendor** | Po |

## 12. Vizioni dhe Misioni

### 12.1 Vizioni

Bashkia Lezhë synon të ndërtojë dhe fuqizojë një sistem vendor të mbrojtjes dhe përkujdesjes sociale që është gjithëpërfshirës, funksional dhe i qëndrueshëm, në përputhje me realitetin lokal, nevojat specifike të komunitetit dhe standardet kombëtare të shërbimeve sociale. Ky sistem vendos në qendër individin dhe familjen, duke garantuar mbështetje të vazhdueshme, orientim drejt përfshirjes dhe mundësimin e një jete me dinjitet për çdo qytetar, veçanërisht për ata që ndodhen në situata vulnerabiliteti. Vizioni reflekton angazhimin për të ofruar shërbime të integruara dhe të aksesueshme, për të reduktuar përjashtimin social dhe për të promovuar një mjedis që mbështet zhvillimin maksimal të potencialit njerëzor, në një shoqëri të drejtë, solidare dhe gjithëpërfshirëse.

### 12.2 Misioni

Bashkia Lezhë, përmes zbatimit të Planit Vendor Social, angazhohet të ndërtojë një sistem të mbrojtjes sociale që garanton ofrimin e shërbimeve cilësore, të aksesueshme dhe të orientuara drejt nevojave reale të qytetarëve të saj. Ky angazhim ndërtohet mbi bazën e barazisë, drejtësisë sociale dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke siguruar që çdo ndërhyrje të jetë në funksion të mbrojtjes, fuqizimit dhe riintegrimit të individëve dhe familjeve në jetën ekonomike e shoqërore të komunitetit. Në themel të këtij misioni qëndron përpjekja për të forcuar rolin e bashkisë si garantuese e mirëqenies së qytetarëve të saj, për të nxitur koordinimin ndërinstitucional në nivel lokal, rajonal dhe kombëtar, si dhe për të promovuar përfshirjen aktive të aktorëve të ndryshëm të komunitetit dhe partnerëve socialë në ndërtimin e një sistemi shërbimesh të integruara dhe reagues ndaj sfidave sociale. Misioni pasqyron bindjen se një shoqëri e fortë ndërtohet duke mbështetur më të dobëtit dhe duke krijuar mundësi të barabarta për të gjithë.

## 13. Plani i Veprimit 2026-2028

Plani i Veprimit 2026-2028 përmirëson dhe thellon ndërhyrjet e planifikuara në ciklin e mëparshëm 2023-2025, duke ndërtuar mbi përvojat, boshllëqet dhe praktikat e identifikuara në analizën e situatës sociale në Bashkinë Lezhë. Objektivat e tij janë hartuar për të forcuar kapacitetet institucionale, për të zgjeruar gamën e shërbimeve sociale, dhe për të rritur aksesin dhe cilësinë e kujdesit për grupet më vulnerabël të shoqërisë.

Plani parashikon 2 qëllime kryesore dhe objektiva specifikë të ndërthurur, që shtrihen në periudhën trevjeçare dhe synojnë:

**Qëllimi 1: Përmirësimi i mirëqenies sociale për individët në nevojë, duke ofruar ndihmë financiare dhe përfitime të drejta që adresojnë nevojat specifike të gjinive dhe grupeve vulnerabël.**

- ✓ Objektivi 1: Përmirësimi i mbështetjes dhe riintegrimit social dhe ekonomik të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, si dhe rritja e mundësive të punësimit

**Qëllimi 2: Garantimi i shërbimeve sociale të aksesueshme, cilësore dhe që respektojnë barazinë gjinore, vulnerabilitetet e ndryshme si dhe avancimi i proceseve të deinstitucionalizimit**

- ✓ Objektivi 1: Forcimi i kapaciteteve për planifikim dhe financim të shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor
- ✓ Objektivi 2: Përmirësimi i shpërndarjes dhe aksesit në shërbimet e kujdesit social, duke u fokusuar në diversifikim, digjitalizim dhe barazi gjinore, sipas nevojave të komunitetit.
- ✓ Objektivi 3: Vazhdimi i transformimit të sistemit të kujdesit rezidecial për fëmijët, duke zhvilluar shërbime në familje, komunitet dhe ditore, që respektojnë interesin më të lartë të fëmijëve
- ✓ Objektivi 4. Ngritja dhe Fuqizimi i Rrjetit Lokal të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror

Të gjitha masat janë të lidhura me indikatorë të qartë dhe të matshëm, duke siguruar që përparimi të jetë i monitorueshëm dhe i raportueshëm. Plani integron burime të ndryshme financimi – përfshirë fondet e bashkisë, donatorë të jashtëm dhe instrumente kombëtare si Fondi Social – për të garantuar zbatueshmëri të ndërhyrjeve të planifikuara.

Kjo qasje siguron vazhdimësi strategjike, adaptim institucional dhe një përqasje më gjithëpërfshirëse për mbrojtjen dhe përkujdesjen sociale në Bashkinë Lezhë, në përputhje me prioritetet kombëtare dhe procesin e decentralizimit të shërbimeve sociale.

## 14. Matrica e Veprimit të Planit Social 2026-2028

**Qëllimi 1: Përmirësimi i mirëqenies sociale për individët në nevojë, duke ofruar ndihmë financiare dhe përfitime të drejta që adresojnë nevojat specifike të gjinive dhe grupeve vulnerabël.**

| OBJEKTIVI SPECIFIK | AKTORË PËRGJEGJËS | AFATI | MASA/AKTIVITETE | INDIKATORË | BURIMI I FINANCIMIT | KOSTO | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 1: Përmirësimi i mbështetjes dhe riintegrimit social dhe ekonomik të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike, si dhe rritja e mundësive të punësimit** | | | | | | | |
| ***1.1 Ndërveprimi i strukturave përgjegjëse të Bashkisë për fuqizimin social/ekonomik të grupeve vulnerabël*** | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social<br>Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit dhe Transparencës<br>Drejtoria e Financës dhe Buxhetit<br>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse | 2026<br>2027<br>2028 | 1.1.1 Fuqizimi dhe rritja e bashkëpunimit të anëtarëve të GTN për të menaxhuar dhe mbështetur rastet e familjeve në nevojë;<br>1.1.2 Organizimi i sesioneve të trajnimit dhe ëorkshopeve për NJVNR për të përmirësuar aftësitë e tyre në vlerësimin e nevojave, referimin e rasteve dhe mbështetjen e familjeve në ndihmë ekonomike<br>1.1.3 Paketa ushqimore për familjet ekstremisht të varfëra nga skema e NE; | Ekipet multidisiplinare të realizuara;<br>Rastet e adresuara<br>Numri i sesioneve të trajnimit dhe ëorkshopeve<br>Numri i përfituesve<br>Numri i paketave të ofruara<br>Numri i fushatave të | Bashkia Lezhë<br>Donatorë | 41,000,000 | Bashkia<br>Këshilli Bashkiak<br>Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | NJA | | 1.1.4 Paketa ushqimore për viktimat e dhunës në familje;<br>1.1.6 Zhvillimi i fushtave të informimit dhe ndërgjegjësimit për komunitetin;<br>1.1.7 Identifikimi i familjeve që mbushin 5 vite në skemën e NE dhe referimi me prioritet pranë zyrave të punës. | ndërgjegjësimit të realizuara<br>Numri i familjeve të identifikuara | | | |
| ***1.2. Ofrimi i mbështetjes financiare për fëmijët, pjesë e familjeve që përfitojnë nga skema e Ndihmës Ekonomike*** | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social Drejtoria e Financës dhe Buxhetit | 2026 2027 2028 | 1.2.1 Mbështetje në formë subvencioni të drejtpërdrejtë për familjet që kanë fëmijë të moshës 0-3 vjeç, duke përfshirë ndihmën për blerjen e produkteve esenciale për fëmijët;<br>1.2.2 Ofrimi i kujdesit dhe mbështetjes për fëmijë nga familjet me të ardhura të ulëta përmes qendrave komunitare, duke siguruar mundësi për kujdes të sigurt dhe nxitje të punësimit të prindërve;<br>1.2.3 Bashkëpunimi me sektorin shëndetësor | Numri i familjeve përfituese<br>Numri i familjeve që përfitojnë shërbime nga qendrat komunitare | Bashkia Lezhë Fondi Social; Donatorë | 31,775,000 | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social Këshilli Bashkiak |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | për ndërgjegjësimin e marrjes së shërbimeve të shëndetit të fëmijëve për familjet që përfitojnë nga skemat e ndihmës ekonomike, duke përfshirë vaksinat, kontrollet mjekësore, dhe trajtimin për sëmundje të zakonshme;<br>1.2.5 Zbatimi i programeve të ushqimit për fëmijët në shkolla, duke siguruar që fëmijët nga familjet në nevojë të kenë qasje në ushqim të shëndetshëm dhe të mjaftueshëm.<br>1.2.6 Zgjerimi i qendrës ditore për fëmijë me PAK për të përfshirë më shumë fëmijë dhe ofruar më shumë shërbime terapeutike. | Numri i familjeve që ndërgjegjësohen për marrjen e shërbimeve shëndetësore<br>Numri i shkollave që zbatojnë programin e ushqimit në shkolla<br>Numri i fëmijëve me PAK të përfshirë në qendrën ditore (rritje vjetore me 10%) | | | |
| ***1.3. Fuqizim përmes punësimit,*** | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social | 2026<br>2027<br>2028 | 1.3.1 Mbështetja e të rinjve (vajza dhe djem) nga zonat rurale dhe | Numri i të rinjve të regjistruar dhe që përfitojnë | Bashkia Lezhë<br>Donatorë<br>Biznese | 8,200,000 | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***kualifikimit, trajnimit dhe mbështetjes financiare*** | Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse<br>Qendrat Komunitare<br>NJA<br>AKPA | | urbane, që janë nga kategoritë në nevojë, për t'u regjistruar dhe përfituar arsimim, trajnime, këshillim dhe punësim;<br>1.3.2 Mbështetje për incentiva të reja biznesi për grupet në nevojë;<br><br>1.3.3 Bashkëpunimi me biznese lokale për të krijuar mundësi punësimi specifikisht për gratë, vajzat, prindërit e vetëm dhe përfituesit e ndihmës ekonomike në moshë pune në zonat rurale;<br>1.3.4 Trajnime për menaxhimin e biznesit dhe qasje në fonde start-up për gratë dhe nënat kryefamiljare që dëshirojnë të hapin biznese të vogla ose të angazhohen në sipërmarrje;<br>1.3.5 Fuqizimi i grave dhe nxitja e sipërmarrjes;<br>1.3.6 Bashkëpunimi i Qendrave komunitare | shërbime të arsimit, trajnimit, këshillimit dhe punësimit<br><br>Numri i grupeve në nevojë që përfitojnë incentive;<br><br>Numri i grave, vajzave, prindërive të vetëm dhe përfitues të ndihmës ekonomike në moshë pune në zonat rurale të punësuar<br><br>Numri i trajnimeve të zhvilluara<br><br>Numri i grave dhe vajzave që marrin pjesë në trajnime | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | dhe NJA me punëkërkues për ti orientuar drejtë punësimit;<br>1.3.7 Riintegrimi socio-ekonomik i individëve vulnerabël dhe mbështetja për punësim. | Numri i grave që zhvillojnë sipërmarrje<br><br>Numri i punëkërkuesve të orientuar drejtë punësimit<br><br>Numri i individëve vulnerabël të mbështetur | | | |
| ***1.4. Koordinimi dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm midis strukturave të Bashkisë, Zyrave të Punës dhe Shërbimit Social Shtetëror me qëllim përgatitjen e individëve të familjeve përfituese të ndihmës*** | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social<br>Shërbimi Social Shtetëror<br>AKPA<br>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve | 2026<br>2027<br>2028 | 1.4.1 Marrëveshje mes Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social dhe AKPA;<br>1.4.2 Zhvillimi i takimeve periodike mes Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujsesit Social të Bashkisë, Drejtorisë së Punësimit të Bashkisë dhe Zyrës Rajonale Lezhë e Agjensisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive;<br>1.4.3 Organizimi i ëorkshop-eve, | Marrëveshja mes Drejtorisë së Shërbimit dhe Kujdesit Social dhe AKPA;<br><br>Numri i takimeve periodike | Bashkia Lezhë<br>Donatorë | 7,300,000 | Kryetari i Bashkisë<br>Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***ekonomike (NE) dhe PAK për integrim në tregun e punës.*** | | | seminareve dhe trajnimeve për të ndihmuar në forcimin e kapaciteteve të stafeve të bashkisë dhe të aktorëve të shoqërisë civile në zhvillimin e ndërmarrjeve sociale;<br>1.4.4 Krijimi i mundësive për aplikime të drejtëpërdrejta nga individët në nevojë duke shfrytëzuar burime si bashkëpunimi me biznese dhe panairet e punës;<br>1.4.5 Këshillim dhe orientim karriere;<br>1.4.6 Lidhja me qendrat e formimit profesional për zhvillimin e kurseve profesionale;<br>1.4.7 Mbështetje psiko-sociale dhe ofrimi i shërbimeve të këshillimit për motivimin e individëve dhe adresimin e barrierave dhe nevojave të tyre;<br>1.4.8 Studim i tregut të punës si dhe profesioneve të reja; | Numri i ëorkshop-eve, seminareve dhe trajnimeve<br>Numri i individëve në nevojë që aplikojnë në panairet e punës<br>Numri i takimeve periodike me fokus orientimin profesional<br>Numri i individëve që ndjekin kurset profesionale<br>Numri i individëve që përfitojnë mbështetje psiko-sociale | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 1.4.9 Projekte për ofrimin e shërbimit të këshillimit të nxënësve dhe qytetarëve në lidhje me zhvillimin profesional dhe strategjitë e suksesit në karrierë; | Raporti i studimit | | | |
| | | | 1.4.10 Organizimi i trajnimeve dhe eventeve të ndryshme si pjesë e shërbimit të karrierës; | Numri i nxënësve dhe qytetarëve që përfitojnë nga shërbimi i këshillimit | | | |
| | | | 1.4.11 Ofrimi i seancave të këshillimit individual dhe në grup si pjesë e shërbimit të karrierës; | Numri i trajnimeve dhe eventeve të zhvilluara | | | |
| | | | 1.4.12 Bashkëpunimi me strukturat dhe institucionet qëndrore dhe lokale për cështjet që kanë të bëjnë me fushën e këshillimit të karrierës dhe zhvillimit profesional. | Numri i individëve që përfitojnë nga seancat e këshillimit individual dhe në grup | | | |
| | | | 1.4.13 Përditësimi i informacionit online në | Numri i takimeve dhe bashkëpunimeve | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | lidhje me shërbimet e zyrës.<br><br>1.4.14 Organizimi i fushatave ndërgjegjësimi për mundësitë e punësimit dhe mbështetje për punësimin e grupeve vulnerabël. | Informacion i përditësuar<br><br>Numri i fushatave të ndërgjegjësimit | | | |

## Qëllimi 2: Garantimi i shërbimeve sociale të aksesueshme, cilësore dhe që respektojnë barazinë gjinore, vulnerabilitetet e ndryshme si dhe avancimi i proceseve të deinstitucionalizimit

| OBJEKTIVI SPECIFIK | AKTORË PËRGJEGJËS | AFATI | MASA/AKTIVITETE | INDIKATORË | BURIMI I FINANCIMIT | KOSTO | MONITORIMI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Objektivi 1: Forcimi i kapaciteteve për planifikim dhe financim të shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor** | | | | | | | |
| ***1.1. Zhvillimi i aftësive për përdorimin e teknikave të ndjekjes dhe vlerësimit të ecurisë së planeve lokale vendore*** | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social<br><br>Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse<br><br>Qendrat Komunitare | 2026 | 1.1.1 Trajnime dhe ëorkshope për punonjësit e gjithë strukturave të shërbimeve sociale mbi teknikat e vlerësimit të planeve lokale vendore;<br>1.1.2 Përmirësimi i mekanizmave për vlerësimin e treguesve dhe produkteve të | Numri i trajnimeve dhe ëorkshopeve<br><br>Databazë lokale<br>Takime<br>Raporte | Bashkia Lezhë<br>Donatorë | 2,600,000 | Kryetari i Bashkisë<br>Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | NJA | | arritura gjatë zbatimit të planeve;<br>1.1.3 Takime dhe aktivitete për koordinimin ndër-institucional dhe me aktorët e tjerë për vlerësmin e planeve;<br>1.1.4 Udhëzues për monitorimin dhe zbatimin e planeve sociale; | Numri i takimeve dhe aktivitete për koordinimin ndër-institucional<br><br>Dokumenti për monitorimin e planeve sociale | | | |
| **Objektivi 2: Përmirësimi i shpërndarjes dhe aksesit në shërbimet e kujdesit social, duke u fokusuar në diversifikim, digjitalizim dhe barazi gjinore, sipas nevojave të komunitetit.** | | | | | | | |
| ***2.1. Digjitalizimi i shërbimeve të kujdesit social për një mbulim më të mirë të grupeve në nevoj*** | MSHMS<br>Shërbimi Social Shtetëror<br>Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social<br>Drejtoria e Financës dhe Buxhetit<br>Qendrat Komunitare<br>NJA | 2027<br>2028 | 2.1.1 Bashkëpunimi me strukturat admnistruese të hartës digjitale të shërbimeve të kujdesit social për pasqyrimin e ofruesve të shërbimeve<br>2.1.2 Popullimi i hartës digjitale të shërbimeve të kujdesit social dhe përditësimi i vazhduar me të dhëna të ndara sipas gjinisë dhe vulnerabilitetit;<br>2.1.3 Ofrimi i trajnimeve për punonjësit e shërbimeve sociale për përdorimin e hartës digjitale dhe | Numri i ofruesve të shërbimeve<br><br>Numri i shërbimeve të pasqyruara në hartën digjitale të shërbimeve të kujdesit social<br><br>Numri i trajnimeve për punonjësit e shërbimeve sociale<br><br>Nevojat lokale te identifikuara për modifikime në regjistrin elektronik të shërbimeve | Bashkia Lezhë<br>Donatorë | 6,800,000 | Zv. Kryetar i Bashkisë;<br>Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | përditësimin e të dhënave;<br>2.1.4 Vlerësimi i nevojës për organizimin e trajnimeve të vazhdueshme për personelin e bashkisë Lezhë për të garantuar përdorimin e duhur dhe efikas të regjistrit elektronik të shërbimeve sociale;<br>2.1.5 Bashkëpunimi me strukturat përgjegjëse për përmirësimin e logjistikës për NJVNR për të mbështetur përdorimin e regjistrit elektronik në digjitalizimin e dokumentacionit. | Numri i trajnimeve të vazhdueshme për personelin e bashkisë<br>Numri i pajisjeve (skanera) të shpërndara në NJVNR | | | |
| ***2.2. Rritja dhe zgjerimi i rrjetit të profesionistëve për identifikimin e rasteve në të gjitha Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR)*** | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social; Drejtoria e Financës dhe Buxhetit; Drejtoria e Shërbimeve Mbështetse; | 2026 | 2.2.1 Konsolidimi i Njësive të Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave në nivel NJA përmes prezantimit të kësaj strukture në ëorkshope, seminare dhe takime të përbashkëta me aktorë të tjerë; | Numri i takimeve në të cilat merr pjesë NJVNR | Bashkia Lezhë Donatorë | 8,300,000 | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Qendrat Komunitare; NJA. | | 2.2.2 Ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për personelin e NJVRN lidhur me menaxhimin e rasteve dhe bashkëpunimin ndërsektorial;<br>2.2.3 Zgjerimi dhe përditësimi i hartës së shërbimeve me të gjitha shërbimet në territor, me financim të bashkisë apo të tjerë dhe përcjellja e kësaj harte te NJA;<br>2.2.4 Bashkëpunimi me punonjësit e shërbimeve shëndetësore për identifikimin, raportimin dhe përmirësimin e manaxhimin e rasteve;<br>2.2.5 NJVNR siguron komunikimin dhe ndërveprimin e vazhdueshëm me ndërlidhesit e komunitetit për rastet në nevojë për shërbime;<br>2.2.6 Zyrat e NJVNR duhet të kenë ambjente | Numri i trajnimeve të vazhdueshme për personelin e NJVRN<br><br>Hartë e shërbimeve e përditësuar<br><br>Numri i rasteve të referuara<br><br>Takime të NJVNR me ndërlidhesit e komunitetit<br><br>Numri i ambjenteve të përshtatshme për intervistimin dhe menaxhimin e rasteve | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | të përshtatshme për intervistimin dhe menaxhimin e rasteve;<br>2.2.7 Vënia në dispozicion e mjeteve të transportit për stafin e NJVNR për realizimin e vlerësimit dhe vizitave në familje, vecanërisht në zonat e largëta. | Mjetet e transportit në dispozicion të stafit të NJVNR | | | |
| ***2.3. Zgjerim dhe diversifikim i shërbimeve në Qendrat Komunitare/Sociale*** | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social; Drejtoria e Financës dhe Buxhetit; Drejtoria e Projekteve Strategjike, Evropës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit ;dhe Transparencës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse | 2026<br>2027<br>2028 | 2.3.1 Shërbime për fëmijën dhe familjen që kanë në fokus prindërimin pozitivë në çdo qendër komunitare;<br>2.3.2 Organizimi i fushatave ndërgjegjësimi për shërbimet e kujdesit social në nivel bashkie, për të siguruar që qytetarët të jenë të informuar për mundësitë që ofrohen dhe mbi parandalimin e fenomeneve të ndryshme (situatë rruge, dhune, abuzim, trafikim, shfrytëzim, përdorim substancash, etj) shkaqet, pasojat e | Numri i trajnimeve për prindërimin pozitivë dhe numri i përfituesve.<br><br>Numri i fushatave të ndërgjegjësimi për shërbimet e kujdesit social në nivel bashkie<br><br>Numri i Takimeve në shkolla<br><br>Sondazhe për të matur kënaqësinë dhe perceptimin e përfituesve të shërbimeve sociale në nivel bashkie | Bashkia Lezhë<br>Donatorë | 3,700,000 | Zv. Kryetari i Bashkisë<br><br>Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | mundësitë për zbutjen e tyre;<br>2.3.3 Bashkëpunimi me strukturat përgjegjëse për kryerjen e anketimeve dhe sondazheve për të matur kënaqësinë dhe perceptimin e përfituesve të shërbimeve sociale në nivel bashkie.<br>2.3.4 Unifikimi i protokolleve të ofrimit të shërbimeve në Qendrat Komunitare (intervistimi, planet e trajtimit, miratimi i instrumentave sipas kategorive në nevojë që përfitojnë në qendra, etj)<br>2.3.5 Ofrimi i supervizimit për stafin e Qendrat Komunitare për trajtimin e konsumimit profesional të profesionistëve. | Protokollet e unifikuara<br>Numri i profesionistëve që përfitojnë supervizim | | | |
| **Objektivi 3: Vazhdimi i transformimit të sistemit të kujdesit rezidecial për fëmijët, duke zhvilluar shërbime në familje, komunitet dhe ditore, që respektojnë interesin më të lartë të fëmijëve** | | | | | | | |
| ***3.1. Të sigurohet një koordinim efektiv akses i*** | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social | 2027 2028 | 3.1.1 Ngritja e mekanizmit koordinues ndërinstitucional për | Mekanizmi koordinues ndërinstitucional | Bashkia Lezhë Donatorë | 5,700,000 | Zv. Kryetari i Bashkisë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| ***barabartë dhe cilësor në shërbime*** | | | monitorimin e procesit: Komiteti Drejtues – nivel qendror e vendor / Grupi teknik – Skuadrat Vendore të Koordinimit;<br>3.1.2 Fuqizimi i shërbimeve sociale dhe të integruara për ndërhyrje të hershme dhe parandalimin e ndarjes së fëmijës nga mjedisi familjar dhe ribashkimin (përfshirë fëmijët me AK; përfshirë shërbimet rezidenciale private);<br>3.1.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel lokal për të siguruar që fëmijët në nevojë të kenë akses në shërbime shëndetësore, edukative dhe mbështetje psikologjike;<br>3.1.4 Ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për punonjësit socialë, psikologët dhe edukatorët për | Shërbime sociale të fuqizuara<br><br>Numri i institucioneve të përfshira<br><br>Numri i trajnimeve të vazhdueshme për punonjësit socialë, psikologët dhe edukatorët për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik | | | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe parandalimin e ndarjes së tyre nga mjedisi familjar;<br>3.1.5 Nxitja e bashkëpunimit me MSHMS për akreditimin e moduleve dhe institucioneve trajnuese për familjet kujdestare (si parakusht i marrjes së vendimeve të gjykatës);<br>3.1.6 Identifikimi në bashkëpunim me NJVNR i familjeve potenciale për kujdestari dhe vlerësimi i tyre;<br>3.1.7 Hartimi i metodologjisë për monitorimin e procesit të deinstitucionalizimit (udhëzues, bazë të dhënash dhe qartësimi i përgjegjësive për mbledhjen dhe përditësimin e të dhënave për kujdestarinë alternative; | Module të akredituara dhe institucione trajnuese për familjet kujdestare<br><br>Familje potenciale për kujdestari të identifikuara<br><br>Metodologjia për monitorimin e procesit të deinstitucionalizimit<br><br>Numri i fushatave ndërgjegjësuese për procesin e DI | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | 3.1.8 Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese për procesin e DI dhe mbështetjen e familjeve kujdestare. | | | | |
| **Objektiv 4. Ngritja dhe Fuqizimi i Rrjetit Lokal të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror** | | | | | | | |
| ***4.1. Ngritja dhe funksionimi i Qendrës multifunksionale për fëmijën dhe familjen në NJA Shënkoll*** | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social | 2026<br>2027<br>2028 | 4.1.1 Përgatitja e infrastrukturës së qendrës sipas profileve të shërbimeve<br>4.1.2 Struktura e personelit dhe pëgatitja e protokolleve operative të punës<br>4.1.3 Trainim i stafit për ofrimin e shërbimeve<br>4.1.4 Funksionimi i shërbimit. | Qendra multifunksionale për fëmijën dhe familjen e ngritur dhe funksionale në NJA Shënkoll;<br>Shërbimi ofrohet në cilësinë që përcaktojnë standartet kombëtare për secilin shërbim përmban qendra; | Bashkia Lezhë<br>MSHMS<br>Donatorë | 40,000,000 | Nënkryetari Bashkisë<br>; Drejtoria Shërbimeve Sociale;<br>DRSHS |
| ***4.2. Ngritja dhe funksionimi i shërbimit të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror në familje kujdestare.*** | Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës;<br>Punonjësit Social të NjVNR'<br>Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës në NjVNR; | 2026<br>2027<br>2028 | 4.2.1 Trainim i strukturave lokale përgjegjëse mbi shërbimin e kujdesit për fëmijë në familje kujdestare<br>4.2.2 Informimi dhe ndërgjegjësimi i komunitetit lokal për të qenë familje kujdestare | Numri i familjeve të informuara mbi shërbimin;<br>Numri i familjeve të vlerësuara dhe të trajnuara si familje të mundshme kujdestare; | Bashkia Lezhë<br>Donatorë | 3,780,000 | Zv. Kryetari i Bashkisë<br>Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Grupi Multidispilinar | | 4.2.3 Identifikimi, orientimi dhe trainimi i familjeve kujdestare<br>4.2.4 Ndjekja e procedurave ligjore për regjistrimin e familjes kujdestare dhe ngritjen e regjistrit të familjeve kujdestare në Bashki<br>4.2.5 Procedurat e vendosjes së fëmijës në familje kujdestare | Numri i familjeve të shqyrtuara nga Komisioni Multidisiplinar | | | |
| ***4.3 Ngritja e një Qendër ditore dhe shërbim të integruar shëndetsorë dhe social për të moshuarit.*** | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social | 2026 | 4.3.1 Qendra kombinon:<br>✓ Shërbime sociale dhe kohës së lirë për të moshuarit,<br>✓ Kujdes shëndetësor,<br>✓ Shërbimet në familje për personat e këssaj grupmoshe sipas nevojave. | Qendra ditore e ngirtur dhe funksionale.<br><br>Numri i përfituesve | Bashkia Lezhë Donatorë | 20,000,000 | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social |
| ***4.4. Krijimi i lehtësive financiare për familjet në nevojë me qëllim përfshirjen në kopshte dhe çerdhe të fëmijëve.*** | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social | 2026<br>2027<br>2028 | 4.4.1 Reduktim me 20% të pagesës për kopësht/çerdhe për fëmijë të familjeve në nevojë;<br><br>4.4.2 Alokimi i kuotave për përfshirje në | Numri i familjeve në nevojë të lehtësuara nga barra financiare;<br><br>Numri fëmijëve që përfshihen në | Bashkia Lezhë | 100,000 | Zv. Kryetari i Bashkisë<br><br>Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | kopshte dhe çerdhe të fëmijëve në nevojë për mbrojtje. Në çdo kopësht dhe çerdhe publike 10% e vendeve janë të disponueshme për këta fëmijë. | kopshte dhe çerdhe për shkak të kuotës së alokuar 10% | | | |
| ***4.5 Ofrimi i Shërbimit të këshillimit me telefon/online*** | Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social | 2027 2028 | 4.5.1 Marrëveshje me linjën e Këshillimit për Fëmijë ALO 116111; Marrëveshje me linjën Kombëtare të Këshillimit për viktimat e dhunës në familje; | Numri i rasteve të fëmijëve që kanë kërkuar dhe kanë marrë këshillim; Numri i rasteve të fëmijëve të referuar tek NJMF përmes linjës së këshillimit; Numri i rasteve të viktimave të dhunës që kanë kërkuar dhe kanë marrë këshillim; Numri i rasteve të vitkimave të dhunës të referuara nga Linja tek koordinatori vendor për masa kundër dhunës në familje; | Bashkia në partneritet me Linjën e Këshillimit për Fëmijë Alo 116111; partneritet me Linjën Kombëtare të Këshillimit | 0 | Zv. Kryetari i Bashkisë<br><br>Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social |

## 15. Monitorimi dhe raportimi

Zbatimi i Planit Vendor Social 2026-2028 do të shoqërohet nga një sistem i dedikuar monitorimi dhe raportimi, i cili siguron ndjekjen në kohë reale të progresit, evidentimin e sfidave dhe përmirësimin e vazhdueshëm të veprimeve të ndërmarra. Ky sistem do të bazohet në një qasje të kombinuar: institucionale, participuese dhe të bazuar në të dhëna.

**Qasja dhe parimet e monitorimit**

Monitorimi do të jetë:

- **i strukturuar**, me përgjegjësi të qarta për çdo njësi zbatuese;
- **i bazuar në tregues të matshëm**, të përcaktuar për çdo aktivitet;
- **i hapur ndaj pjesëmarrjes së komunitetit dhe aktorëve jo publikë**, për të garantuar transparencën dhe përfshirjen.

**Njësia e ngarkuar me monitorimin e zbatimit të aktiviteteve:**

- **Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social,** do të luajë rolin koordinues dhe teknik për grumbullimin dhe analizën e të dhënave, do të ndjekë progresin në nivel strategjik dhe do të raportojë në Këshillin Bashkiak.
- **Drejtoritë dhe njësitë zbatuese përkatëse** janë përgjegjëse për dërgimin periodik të informacionit mbi zbatimin e aktiviteteve.

**Treguesit e matjes së performancës së shërbimeve të kujdesit shoqëror:**

- Për secilin aktivitet në plan janë përcaktuar tregues të qartë si: numri i trajnimeve të realizuara, numri i strukturave të ngritura, ngirtja dhe funksionalizimi i shërbimeve të reja, etj. Treguesit aty ku është e mundur paraqitne të ndarë sipas gjinisë, sipas grupmoshës dhe zonës (urbane/rurale). **Treguesit paraqiten të detajuar në planin e veprimit, për secilin aktivitet.**

**Formatet e raportimit**

Raportimi do të realizohet:

- **Çdo 6 muaj**, përmes një formati të thjeshtuar të mbledhjes së të dhënave dhe analizës së realizimit të planit social, që do të përdoret nga të gjitha drejtoritë dhe njësitë administrative.
- **Çdo vit**, përmes një raporti të përmbledhur vjetor mbi progresin e Planit, i cili do të publikohet në faqen e internetit të bashkisë dhe do t'u prezantohet këshilltarëve dhe komunitetit.

- Raporti vjetor do të përmbajë analiza të të dhënave, shembuj praktikë nga territori, si dhe rekomandime për përmirësim të mëtejshëm.

**Mbledhja e të dhënave, analiza dhe dixhitalizimi**

Brenda vitit të parë të zbatimit, do të krijohet një regjistër dixhital për monitorimin dhe publikimin e statistikave dhe progresit të planit. Ky informacion do të jetë e hapur për publikun, duke mundësuar qasje transparente në të dhëna dhe nisma.

**Vlerësimi ndërmjetës dhe përfundimtar**

Në fund të vitit 2027 do të realizohet një vlerësim ndërmjetës, për të analizuar ritmin e zbatimit dhe për të bërë rregullime në plan, nëse është e nevojshme. Në vitin 2028, do të përgatitet raporti përfundimtar i zbatimit, që do të shërbejë si bazë për hartimin e planit të ardhshëm.

## 16. Bibliografi

Asambleja e Kombeve të Bashkuara. (1948). *Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut*.

Kuvendi i Shqipërisë. (2016). *Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror"*. Fletorja Zyrtare nr. 193, datë 14.11.2016.

Kuvendi i Shqipërisë. (2014). *Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"*. Fletorja Zyrtare nr. 215, datë 17.12.2015.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2020). *Standardet minimale për shërbimet sociale në komunitet për persona në nevojë*. Lezhë.

Këshilli i Ministrave. (2018). *VKM nr. 505, datë 13.09.2018 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të shërbimeve sociale"*. Fletorja Zyrtare.

Këshilli i Ministrave. (2018). *VKM nr. 118, datë 13.3.2018 "Për procedurat e licencimit dhe akreditimit të ofruesve të shërbimeve sociale"*.

Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve. (2022). *Manuali për monitorimin e standardeve të shërbimeve për fëmijë*.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. (2021). *Udhëzues për menaxhimin e rasteve në shërbimet sociale komunitare*.

Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). (2022). *Raporti për kapacitetet e njësive të vetëqeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve sociale*.

Save the Children Albania & UNICEF Albania. (2021). *Manual praktik për bashkitë për zhvillimin e shërbimeve sociale*.

*Lista e legjislacionit të marrë në analizë*

Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar; (në veçanti Nenet 49, 51, 52, 55);

• Ligj nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë";

• Ligji nr. 7531, datë 11.12.1991 "Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (OKB)";

• Ligji nr.7767, datë 9.11.1993 "Për aderimin në Konventën "Për eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave";

• Ligji nr. 104/2012, datë 8.11.2012 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje";

• Ligji nr. 108 , datë 2012 "Për ratifikimin e Konventës së OKB -së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara";

- Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut" dhe Protokolli nr. 7 i KEDNj;
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji nr. 8774, datë 23.4.2001 "Për ratifikimin e Konventës nr.182 "Format më të këqija të punës së fëmijëve, 1999" të Organizatës Ndërkombëtare të Punës";
- Ligj nr. 9359, datë 24.3.2005 "Për ratifikimin e Konventës Evropiane "Për marrëdhëniet me fëmijët";
- Ligji nr. 10 071, datë 9.2.2009 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual";
- Ligji nr. 10 425, datë 2/6/2011 "Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve;
- **Ligji nr. 121, datë 24.11.2016, "Mbi Shërbimet e Kujdeist Shoqëror në Republikën e Shqipërisë";**
- Ligji nr. 163/2014 "Për urdhërin e punonjësve social në Republikën e Shqipërisë ";
- Ligji nr. 40/2016, i ndryshuar "Për urdhërin e psikologut në Republikën e Shqipërisë»;
- **Ligji 18/2017 "Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës";**
- **Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri";**
- Ligji nr. 221 datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar ;
- **Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";**
- Ligji 15/2019 "Për nxitjen e punësimit";
- Ligj nr. 7889, datë 14.12.1994 "Për statusin e invalidit", i ndryshuar;
- Ligj nr. 8098, datë 28.03.1996 "Për statusin e të verbrit", i ndryshuar;
- Ligj nr. 8626, datë 22.06.2000 "Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i

  ndryshuar;
- Ligj Nr. 65/2016 datë 9.6.2016 "Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë";
- Karta Europiane për Autonomi Lokale;
- VKM nr 597, datë 4.9.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" (ndryshuar me vendimin nr. 85, datë 10.2.2021;nr. 868, datë 29.12.2021; nr. 617, datë 22.9.2022);

• VKM nr. 182, datë 26.2.2020 "Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmësit personal" i ndryshuar;

• VKM nr. 722, datë 11.11.2019 "Për përcaktimin e masës, të kritereve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre" i ndryshuar;

• VKM nr.31, datë 20.1.2001 "Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik", i ndryshuar;

• VKM nr.78, datë 7.2.2007 "Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë", i ndryshuar;

• VKM nr.869, datë 18.6.2008 "Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 "statusi i invalidit", i ndryshuar;

• VKM nr.277 date 18.6.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbërit";

• Vendim nr. 257, datë 5.5.2021 "Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale";

• Vendim nr. 135, datë 7.3.2018 "Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror", i ndryshuar;

• Vendim nr. 617, datë 20.10.2021 "Për treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre";

• Vendim nr. 751, datë 1.12.2022 "Për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç";

• Vendim nr. 56, datë 31.1.2018 "Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara";

• Vendim nr. 174, datë 24.3.2023 "Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2023–2025";

• VKM Nr. 768 datë 15.12.2021 "Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të vecanta";

• VKM 518/2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar";

• **VKM Nr. 149, datë 13.3.2018 "Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare";**

• VKM 136/2018 "Për funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror";

• VKM Nr. 135, datë 7.3.2018 "Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror";

• VKM Nr. 848, datë 28.10.2020 "Për standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të ofruesve të tyre";

• **VKM Nr. 624, datë 29.07.2020 "Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror";**

• VKM nr. 111 datë 23 shkurt 2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social;

• VKM Nr. 150 datë 20/03/2019 "Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.